



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

ANALIZA VJETORE 2015



Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe funksionimin e Sistemit të Prokurimit Publik për periudhën nga 1 Janar deri në 31 Dhjetor 2015.

Përmbajtja

1. HYRJE	3
1.1. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA.....	3
2. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2015	5
2.1. Ndryshimet legjislative	5
2.1.1. Prokurimi Publik.....	5
2.1.1.1. Iniciativat nënligjore të APP	5
2.1.1.2. Udhëzime dhe Vendime të APP	5
2.1.2. Koncesionet dhe partneriteti publik privat	13
3. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2015	14
4. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE	16
4.1. Bashkëpunimi i APP me institucione homologe të vendeve të rajonit dhe të BE-së	16
4.2. Bashkëpunimi i APP me institucione të tjera në Shqipëri	16
5. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË SEKTORIT JURIDIK PRANË DREJTORISË JURIDIKE DHE MONITORIMIT 18	
5.1. Ndryshimet në kuadrin ligjor	18
5.2. Praktikat e shqyrtuara për dhënie mendimesh, këshilla apo udhëzimesh gjatë këtij viti.....	18
5.3. Shqyrtimi i propozimeve për përjashtimin e operatorëve ekonomikë	20
5.4. Përfaqësimi në proceset gjyqësore	21
6. MONITORIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT	25
6.1. Monitorimi i Procedurave të prokurimit nga APP	25
6.2. Shqyrtimi i raporteve audituese	29
6.3. Monitorime për procedura koncesioni.....	31
7. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PUBLIKIMEVE.....	32
7.1. Sektori i Publikimeve	32
7.1.1. Njoftime për Procedura	32
7.1.2. Njoftime për Ankande Publike.....	33
7.1.3. Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat.....	33

7.2.	Statistika në lidhje me numrin e procedurave të prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, të shpallura gjatë vitit 2015.....	34
7.2.1.	Statistika për procedurat e prokurimit të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik....	34
7.2.1.1.	Statistika sipas Njoftimit të kontratës.....	34
7.2.1.2.	Statistika sipas llojit të procedurave	35
7.2.1.3.	Statistika për njoftimet e fituesit	36
7.2.1.4.	Statistika për kontratat e nënshkuara	38
7.2.1.5.	Statistika mbi përqindjen e kursyer	39
7.2.2.	Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.....	41
7.2.3.	Marrëveshjet Kuadër.....	46
7.2.4.	Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël	47
7.2.5.	Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP gjatë vitit 2015	48
7.2.6.	Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2015	49
7.3.	sektori i teknologjisë së informacionit	50
7.3.1.	Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP	54
7.3.2.	Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2015	55
7.3.3.	Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik.....	58
7.3.4.	Statistika në lidhje me ofertat e krijuara në sistemin elektronik për procedurat e arkivuara	59
7.3.5.	Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik	59
8.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE, INTEGRIMIT DHE FINANCËS.....	63
8.1.	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	63
8.2.	Autoriteti Përgjegjës.....	64
8.3.	Aktivitetet në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve administrative të stafit të APP dhe specialistëve të prokurimit publik pranë autoriteteve kontraktore.....	64
8.3.1.	Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare	64
8.3.2.	Trajnimet e stafit të APP	65
8.3.3.	Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë Autoriteteve Kontraktore	66
8.4.	Integrimi	67
8.5.	Gjendja financiare e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2015.....	68
9.	PRIORITETET E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2016	71

1. HYRJE

Ky raport pasqyron punën e Agjencisë së Prokurimit Publik (këtu e në vijim “APP”) dhe funksionimin e sistemit të prokurimit publik për periudhën nga 1 Janar 2015 deri në 31 Dhjetor 2015.

Gjatë vitit kalendarik 2015, APP e ka ushtruar veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar si dhe në bazë të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 143, datë 06.07.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

1.1. ASISTENCA E PROJEKTEVE TË HUAJA

Gjatë vitit 2015, APP nuk ka qenë pjesë e ndonjë projekti të financuar nga donatorë apo organizata ndërkombëtare.

Megjithatë, sikurse dhe në vitet paraardhëse, edhe gjatë këtij viti, APP ka vazhduar të asistohet nga SIGMA (Programi për Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit në Evropën Qëndrore dhe Lindore) për përmbushjen e detyrimeve të saj në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Gjatë këtij viti, asistenca e SIGMA-s ka qenë e fokusuar kryesisht në hartimin e Manualit për Marrëveshjet Kuadër dhe zhvillimin e aktiviteteve trajnuese, në bashkëpunim me përfaqësues të APP, për institucionet qendrore, në këtë drejtim.

Gjithashtu, gjatë këtij viti SIGMA ka dhënë asistencë në organizimin e aktiviteteve përgatitore si takime dhe trajnime të nevojshme në lidhje me fillimin e punës për përafrimin e Direktivës së BE-së nr. 2009/81/KE mbi koordinimin e procedurave për dhënie të kontratave për punë, kontratave për furnizime dhe kontratave të shërbimit nga autoritetet kontraktore apo entet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Po kështu gjatë vitit 2015, APP, së bashku me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit, ka qenë përfutuese e projektit të Bankës Botërore ‘Përmirësimi i monitorimit të përputhshmërisë dhe rritja e transparencës në prokurimin publik në Shqipëri’, zbatimi i të cilit do të fillojë në vitin 2016.

Ky projekt ka për qëllim të mbështesë Qeverinë Shqiptare për të përmirësuar dhe përforcuar më tej sistemin e monitorimit të përputhshmërisë me ligjin për prokurimin publik, për të përmirësuar mekanizmat e shqyrtimit të ankesave, si edhe të rrisë kapacitetet e KLSH për auditimin e kontratave të prokurimit publik në Shqipëri.

2. INICIATIVAT LEGJISLATIVE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2015

2.1. NDRYSHIMET LEGJISLATIVE

2.1.1. Prokurimi Publik

2.1.1.1. Inicativat nënligjore të APP

Në kuadër të ndryshimeve që pësoi ligji i prokurimit publik, ndryshimet e të cilit u miratuan me Ligjin Nr. 182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të ndryshimeve përkatëse në rregullat e prokurimit publik, të cilat u miratuan me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, APP në fillim të vitit 2015 ka punuar për hartimin e akteve nënligjore, të cilat u prekën nga ndryshimet përkatëse ligjore dhe nënligjore, por edhe për hartimin e Udhëzimeve, të cilat do t’i vinin në ndihmë autoriteteve kontraktore për zbatimin e këtyre ndryshimeve.

Si pasojë e shfuqizimit të Vendimit Nr. 1, datë 10.01.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, u pa e nevojshme edhe shfuqizimi i Vendimit Nr. 53, datë 21.01.2009 i Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, të ndryshuar, i cili mbështetej në këto rregulla.

Në këtë kuadër, APP ka punuar për hartimin e projektvendimit i cili më pas është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 28, datë 14.01.2015, “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”. Ky Vendim nuk pati ndryshime në përmbajtje krahasuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.53 datë 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, të ndryshuar.

2.1.1.2. Udhëzime dhe Vendime të APP

Gjatë vitit 2015, për t’u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, APP ka hartuar Udhëzimet si më poshtë:

- ❖ **Udhëzimi Nr. 1, datë 27.01.2015** “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, nga organi qendror blerës, Ministria e Punëve të Brendshme, për disa mallra dhe shërbime, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë”.

Për shkak të shfuqizimit të Vendimit Nr. 53 datë, 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime”, të ndryshuar, si dhe të miratimit dhe hyrjes në fuqi të VKM Nr. 28, datë 14.01.2015, APP rishikoi edhe udhëzimin përkatës, i cili shoqëronte VKM Nr. 53 datë 21.01.2009.

Si rrjedhojë u hartua dhe hyri në fuqi Udhëzimi Nr.1, datë 27.01.2015, i cili nuk pati ndryshime thelbësore në përmbajtje por vetëm u ndryshua baza ligjore mbi të cilin duhej të mbështetej.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 2, datë 27.01.2015** “Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik”.

Miratimi i rregullave të prokurimit publik me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, solli ndërmjet të tjerave edhe shkurtimin e afateve për paraqitjen e regjistrit të parashikimit të prokurimeve në institucionin qendror dhe në APP. Shkurtimi i këtyre afateve u bë duke pasur parasysh që autoritetet kontraktore bëjnë paraprakisht planifikimin e nevojave të tyre, për të cilat kërkojnë dhe miratimin e një buxheti të caktuar.

Në kuadër të këtij ndryshimi, për t’u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore, APP ka hartuar Udhëzimin Nr. 2, datë 27.01.2015.

Risia që solli ky udhëzim ishte jo vetëm sqarimi i autoriteteve kontraktore mbi afatet kohore brenda të cilave duhej të dërgonin pranë APP apo institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore regjistrat e parashikimit dhe të realizimit të prokurimit publik, por edhe hartimi i formularëve standardë të këtyre regjistrave, me qëllim unifikimin e formatit të publikimit të tyre.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 3, datë 27.01.2015** “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” solli ndryshime edhe në Kreun përkatës për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël.

Kështu, për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël u parashikua që në rastin kur këto procedura kryhen me mjete elektronike, autoriteti kontraktor të ftojë të paktën pesë operatorë ekonomikë (kur është e mundur). Ky ndryshim është bërë me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

Gjithashtu, për t'i dhënë fund zvarritjes së procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sidomos në rastet kur numri i ofertuesve është shumë i madh dhe operatorët ekonomikë ofertues nuk i përgjigjen autoritetit kontraktor, u parashikua që autoriteti kontraktor në këtë lloj procedure do të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm ofertat e operatorëve ekonomikë të renditur deri në vendin e 5 të klasifikimit.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 4, datë 27.01.2015** “Për kryerjen e procedurave të prokurimit të përbashkëta, nga autoritete kontraktore që kanë nevojë për të njëjtin mall, shërbim, apo punë”.

Ky dokument i hartuar nga APP ka për qëllim të udhëzojë autoritetet kontraktore që nëse kanë nevojë të prokurojnë të njëjtin mall, punë ose shërbim, ata mund të bien dakord t'i caktojnë njërit prej tyre rolin e organit qendror blerës, për të prokuruar në emër të tyre, në bazë të një marrëveshjeje të shkruar.

Ky udhëzim nuk pati ndonjë ndryshim në përmbajtje, por ai u rihartua pas shfuqizimit të Vendimit Nr. 1, datë 10.01.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 5, datë 27.01.2015** “Për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik”.

Ky udhëzim ka si qëllim të udhëzojë komisionet e prokurimit me vlerë të vogël të ngritur pranë autoriteteve kontraktore mbi mënyrën e veprimit në lidhje me krijimin, shpalljen dhe vlerësimin e një procedure prokurimi me vlerë të vogël, në sistemin e prokurimit elektronik.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 6, datë 27.01.2015** “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër”.

Ndryshimet e fundit të miratuara në ligj dhe në rregullat e prokurimit publik parashikuan, ndër të tjera, përdorimin e marrëveshjes kuadër edhe në procedurat e prokurimit “Shërbim

Konsulence” dhe “Kërkesë për Propozim”, detajimin e llojeve të marrëveshjeve kuadër dhe hapat që ndiqen në rastin e aplikimit të saj, si edhe mundësinë e ofertimit nga operatorët ekonomikë me çmim për njësi apo marzh fitimi, në rastin e marrëveshjes kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara. Për reflektimin e ndryshimeve të mësipërme u pa i nevojshëm rishikimi i udhëzimit ekzistues të APP.

Udhëzimi i ri i hartuar nga APP, jo vetëm që parashikon të gjitha ndryshimet ligjore e nënligjore që pati në lidhje me marrëveshjen kuadër, por gjithashtu, në mënyrë më të detajuar, udhëzon autoritetet kontraktore mbi hapat që duhet të ndjekin në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër.

Konkretisht, për të shmangur zvarritjet dhe për të operuar në një kohë të shpejtë për plotësimin e nevojave u parashikua mundësia e komunikimit me mjete elektronike (e-mail, fax) ndërmjet autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë në procedurat e minikonkursit.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 7, datë 19.03.2015** “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 6, datë 27.01.2015 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër”.

Ky udhëzim ka sjellë disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 6, datë 27.01.2015 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër”. Ndryshimet e reflektuara në këtë udhëzim erdhën jo vetëm si pasojë e problematikës së shfaqur në përdorimin e marrëveshjes kuadër, por edhe për të lehtësuar më shumë autoritetet kontraktore gjatë zbatimit të saj.

Konkretisht, ky udhëzim parashikon se marrëveshja kuadër mund të lidhet edhe ndërmjet një autoriteti kontraktor dhe një operatori ekonomik. Gjithashtu, parashikohet vendosja e një afati për dërgimin e njoftimit të kontratave të lidhura nga autoriteti kontraktor gjatë një viti kalendarik, për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike, në formë të shkruar dhe elektronike (CD). Ky afat është jo më vonë se data 10 janar e vitit në vijim.

Po kështu, u parashikua se dhënia e kontratave në bazë të një marrëveshje kuadër të realizuar nga një autoritet kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës do të bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese. Njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik, do të dërgohet nga autoriteti kontraktor përfitues në Agjencinë e Prokurimit Publik për publikim.

Një ndryshim tjetër në këtë udhëzim ka të bëjë me përbërjen e komisionit të vlerësimit të ofertave. Përbërja e këtij komisioni që do të krijohet gjatë rihapjes së konkurrimit, në rastin e

marrëveshjes kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, mund të mos jetë identike me atë të komisionit të vlerësimit të ofertave, të përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrëveshjen kuadër.

Për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore për zbatimin sa më mirë në praktikë të parashikimeve ligjore dhe nënligjore për përdorimin e marrëveshjes kuadër, Agjencia e Prokurimit Publik, në bashkëpunim me SIGMA-n, ka hartuar dhe publikuar edhe Manualin "Dhënia dhe Përdorimi i Marrëveshjeve Kuadër", i cili është publikuar në faqen zyrtare të Internetit të APP.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 7, datë 22.05.2015** "Për veprimet e Njësisë së Prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik".

Ky udhëzim ka si qëllim të udhëzojë të gjitha Njësitë e Prokurimit të ngritura pranë autoriteteve kontraktore mbi mënyrën e veprimit në lidhje me krijimin dhe shpalljen e një procedure prokurimi në sistemin e prokurimit elektronik.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 8, datë 22.05.2015** "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik".

Ky udhëzim ka si qëllim të udhëzojë hap pas hapi autoritetet kontraktore, se si duhet të veprojnë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 9, datë 22.05.2015** "Për rolin e Auditit në sistemin e prokurimit elektronik".

Ky udhëzim ka si qëllim të udhëzojë të gjithë audituesit mbi mënyrën se si duhet të punohet nga llogaria e "Audit-it" të autoritetit kontraktor, në sistemin e prokurimit elektronik.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 10, datë 22.05.2015** "Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik".

Ky udhëzim ka si qëllim të udhëzojë të gjithë operatorët ekonomikë mbi mënyrën e regjistrimit në sistemin e prokurimit elektronik dhe mbi mënyrën e dorëzimit të ofertave të tyre.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 11, datë 22.05.2015** “Për procesin e pezullimit, modifikimin e dokumentave standarde të tenderit dhe shtyrjen e afatit të procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik”.

Ky udhëzim ka si qëllim të udhëzojë të gjithë autoritetet kontraktore se si duhet të veprojnë për pezullimin, modifikimin e dokumentave standarde të tenderit, si dhe shtyrjen e afatit të procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 12, datë 22.05.2015** “Për krijimin e llogarive të përdoruesve nga administratori i sistemit”.

Ky udhëzim ka si qëllim të udhëzojë të gjithë autoritetet kontraktore, për krijimin e llogarive të përdoruesve nga administratori i sistemit, në sistemin e prokurimit elektronik.

- ❖ **Udhëzimi Nr. 13, datë 28.05.2015** “Për procedurat e dhënies me koncesion dhe partneritet publik privat në sistemin e prokurimit elektronik dhe dorëzimi i ofertave nga operatorët ekonomikë”.

Ky udhëzim ka si qëllim të udhëzojë të gjithë autoritetet kontraktore mbi mënyrën e krijimit të dosjes në procedurat e dhënies me koncesion dhe partneritet publik privat, deri në fazën e pritjes së ofertave.

❖ **Vendimet për miratimin e Dokumentave Standarde të Tenderit**

Si rezultat i ndryshimeve në rregullat e prokurimit publik, të cilat u miratuan me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, Agjencia e Prokurimit Publik hartoi dhe miratoi Dokumentat Standarde të Tenderit për Mallra/Punë/Shërbime me anë të Vendimit Nr. 1, datë 22.01.2015.

Në këtë set të ri të Dokumentave Standarde të Tenderit u pasqyruan të gjitha ndryshimet ligjore dhe nënligjore që pati legjislacioni i prokurimit publik, në fund të vitit 2014.

Konkretisht, seti i ri i Dokumentave Standarde të Tenderit u thjeshtua për t’u ardhur në ndihmë jo vetëm autoriteteve kontraktore, por edhe operatorëve ekonomikë, në drejtim të paraqitjes së formularëve standardë si pjesë të ofertës të tyre.

Seti i veçantë i Dokumentave Standarde të Tenderit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje u shfuqizua. Të gjitha parashikimet që kishte ky set në lidhje me mënyrën e prokurimit të këtij objekti dhe formularët përkatës u përfshinë në setin e ri të Dokumentave Standarde të Tenderit për Mallra, për Procedurën e Hapur dhe Kërkesën për Propozim.

Duke qenë se, për procedurën e prokurimit “Konkurs Projektimi” nuk ka patur një set të veçantë të dokumentave standarde të tenderit, APP hartoi dhe miratoi setin përkatës edhe për këtë lloj procedure prokurimi.

Gjithashtu, të rejat që solli seti i ri i Dokumentave Standarde të Tenderit për Mallra/Punë/Shërbime synojnë thjeshtimin e udhëzimeve për operatorët ekonomikë, duke hequr ato pjesë të panevojshme në udhëzimet ekzistuese.

Në këtë set u pasqyrua dhe ndryshimi ligjor sipas të cilit paraqitja e Sigurimit të Ofertës, zbatohet vetëm për procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, vetëm në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor.

Po kështu, u hoq nga DST shtojca “Formular i Kontratës”, si një formular i papërshtatshëm dhe i panevojshëm në kushtet kur ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik fitues lidhet kontrata, si dhe u shtua formulari i njoftimit të fituesit në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, duke qenë se në këtë rast do të kemi më shumë se 1 fitues.

Së fundmi, u rishikuan të gjitha Shtojcat e tjera, për t’i përshtatur ato me ndryshimet më të fundit ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

Duke patur në konsideratë që edhe procedurat e dhënies me koncesion/PPP, zhvillohen sipas parashikimeve në legjislacionin e prokurimit publik, APP ka reflektuar ndryshimet ligjore të prokurimit publik, në setin e dokumentave standarde të procedurës së koncesioneve/PPP-ve (këtu e në vijim DSK/PPP) për kontratat e punëve civile dhe shërbimeve, të cilat u miratuan me Vendimin Nr. 2, datë 12.02.2015.

Konkretisht, këto ndryshime konsistojnë në reflektimin e parashikimit ligjor (nenit 49 të LPP), sipas të cilit, për procedurat e prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të paraqesin sigurimin e ofertës.

Në setin e DSK/PPP për kontratat e punëve civile dhe shërbimeve, ky ndryshim është pasqyruar në seksionin përkatës të Udhëzimeve për Ofertuesit, si dhe në Shtojcën përkatëse të sigurimit të ofertës (Shtojca 3).

Gjithashtu, në setin e DSK/PPP për kontratat e punëve civile dhe shërbimeve është pasqyruar edhe Vendimi i APP Nr. 1 datë 21.01.2014, për një shtesë në setin e dokumentave standarde që përdoren në procedurën e prokurimit, duke shtuar në setin e DSK/PPP për kontratat e punëve civile dhe shërbimeve Shtojcën Nr. 10 “Deklarata e gjendjes gjyqësore”.

Me anë të kësaj shtojce, operatorët ekonomikë do të deklarojnë që nuk janë të dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP, si dhe nuk janë të dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional, duke qenë se një informacion i tillë nuk mund të merret nëpërmjet ekstraktit të regjistrit tregtar të shoqërisë.

Si rezultat i hyrjes në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 401, datë 13.05.2015 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedure prokurimi të koncensioneve”, me Vendimin Nr. 3, datë 26.05.2015, Agjencia e Prokurimit Publik miratoi një ndryshim në njoftimin e kontratës pjesë e Dokumentave Standarde të Koncensionit/Partneritetit Publik Privat për Punë dhe Shërbime, duke pasqyruar parashikimin që ka të bëjë me vendosjen nga ana e autoritetit kontraktor të vlerës së tarifës që duhet të paguajë operatori ekonomik, në rast ankese në KPP.

❖ **Rekomandime dhe Njoftime**

Si rezultat i problematikave të shumta të ndeshura në prokurimin e *shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike*, Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, në vijim të vendimeve të këtij të fundit në lidhje me këtë lloj procedure, kanë hartuar një rekomandim mbi mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit për këtë lloj procedure prokurimi nga autoritetet kontraktore si dhe për paraqitjen e ofertave nga operatorët ekonomikë. Ky rekomandim është publikuar në faqet zyrtare të Internetit të dy institucioneve.

Gjithashtu, duke u nisur nga problematika e ndeshur së fundmi nga Agjencia e Prokurimit Publik në kriteret për kualifikim që autoritetet kontraktore vendosin në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, ajo ka udhëzuar këto autoritete nëpërmjet një njoftimi të publikuar në faqen e saj të internetit që, në rastin kur këto autoritete kanë nevojë të kërkojnë mostra për objektin që do të prokurojnë, apo edhe në rastet kur kërkojnë dokumentacion shkresor për t’u

përbushur, duhet të kenë kujdes që mostrat apo dokumentacioni nuk duhet t'u kërkohe të gjithë ofertuesve, por vetëm operatorit ekonomik të renditur në vend të parë, përpara se të shpallet fitues.

Një tjetër Njoftim i përgatitur nga Agjencia e Prokurimit Publik, drejtuar të gjitha autoriteteve kontraktore, është nxitur nga problematika e hasur për shkak të anulimit të procedurave të prokurimit, ndërkohë që kanë qenë në proces ankimi. Nëpërmjet këtij njoftimi i është tërhequr vëmendja të gjitha autoriteteve kontraktore që të mos marrin vendime për anulimin e procedurës së prokurimit, pa kaluar afatet e parashikuara në LPP për ankimin administrativ.

Gjatë vitit 2015, APP ka përgatitur dhe Njoftime drejtuar autoriteteve kontraktore për të marrë masat për arkivimin e procedurave të prokurimit të përfunduara, në sistemin e prokurimit elektronik.

2.1.2. Koncesionet dhe partneriteti publik privat

Gjatë vitit 2015, APP ka qenë pjesë e grupit të punës të ngritur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me qëllim hartimin e disa ndryshimeve në Ligjin Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.

Një nga risitë që solli Ligji Nr. 77/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i cili u miratua në 16 Korrik 2015, ishte kalimi i kompetencave legislative dhe të drejtën për propozimin e akteve ligjore e nënligjore në këtë fushë, nga Agjencia e Prokurimit Publik, tek Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Gjithsesi, edhe pas ndryshimeve të bëra nga ky ligj, APP do të vazhdojë të kryejë monitorimin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP, përjashtimin e operatorëve ekonomikë, si dhe publikimin e dokumenteve standarde.

3. SFIDAT DHE ARRITJET KRYESORE TË AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK GJATË VITIT 2015

Sfidat kryesore me të cilat është përballur APP, gjatë vitit 2015, kanë konsistuar kryesisht:

- i. në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore dhe konkretisht Udhëzimeve të APP, me qëllim, reflektimin e ndryshimeve që ndodhën në fund të vitit 2014, në kuadrin legjislativ të prokurimeve publike;
- ii. në nxitjen e autoriteteve kontraktore për përdorimin e marrëveshjes kuadër, si një mjet që do të ulë numrin e procedurave me negociim pa shpallje paprapake;
- iii. në monitorimin e procedurave të prokurimit publik, në menaxhimin e sistemit të prokurimit elektronik, si dhe rritjen e kapaciteteve të këtij sistemi, në kushtet kur të gjitha procedurat e prokurimit publik që kërkojnë njoftim paraprak, përfshirë dhe procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, zhvillohen me mjete elektronike;
- iv. në ngritjen e kapaciteteve administrative të punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik në vend.

Përmirësimi i legjislacionit në këtë fushë, për të cilin APP është angazhuar maksimalisht, përveçse një detyrë ligjore e kësaj të fundit, është njëkohësisht edhe një detyrë që vjen nga detyrimet e marra përsipër në kuadër të procesit të integritetit dhe më konkretisht të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian.

Me përfundimin e këtyre dy akteve ligjore dhe nënligjore, në fund të vitit 2014, një sfidë për APP ishte përgatitja e të gjitha akteve të tjera nënligjore, përfshirë dhe Dokumentet Standarde të Tenderit. Pjesa më e madhe e këtyre akteve u hartuan dhe u miratuan brenda muajit Janar 2015, për të mos penguar veprimtarinë e autoriteteve kontraktore.

Një sfidë me të cilën është përballur APP gjatë vitit 2015, ka qenë dhe nxitja e autoriteteve kontraktore të përdorin Marrëveshjen Kuadër. Për këtë qëllim, në vijim dhe të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore përkatëse, APP hartoi dhe miratoi një udhëzim të detajuar mbi procedurën që duhet të ndiqnin autoritetet kontraktore gjatë përdorimit të një marrëveshje kuadër.

Gjithashtu një tjetër iniciativë e APP në këtë drejtim, ishte hartimi në bashkëpunim dhe me SIGMA-n, i një Manuali mbi Përdorimin e Marrëveshjes Kuadër, i cili synon të ndihmojë dhe lehtësojë punën e autoriteteve kontraktore në këtë drejtim. Në vijim të përgatitjes së këtij Manuali, APP po në bashkëpunim me SIGMA, organizoi dy trajnime një ditore me përfaqësues të nivelit të lartë drejtues dhe përfaqësues të nivelit teknik në ministritë e linjës. Si rezultat i

këtyre iniciativave dhe aktiviteteve, viti 2015 ishte viti i parë kur Marrëveshjet Kuadër filluan të përdoreshin nga autoritetet kontraktore, kryesisht për biletat e transportit ajror.

Edhe këtë vit, APP ka pasur si sfidë monitorimin e procedurave të prokurimit publik të kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore, me fokus procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe procedurat e denoncuara në portalin “Stop Korrupsionit”. Qëllimi i procesit të monitorimit ka qenë evidentimi i shkeljeve procedurale, si në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, ashtu edhe në fazën e përgatitjes dhe vlerësimit të procedurës konkrete. Me vendimet e marra në përfundim të procedurave monitoruese, APP ka synuar jo vetëm marrjen e masave ndëshkuese për personat përgjegjës që kanë shkelur legjislacionin e prokurimit publik, por edhe udhëzimin e autoriteteve kontraktore për mos përsëritjen e shkeljeve në të ardhmen. APP e ka kryer me përgjegjësi dhe seriozitet këtë detyrë (edhe pse jo me kapacitetin e plotë të punonjësve të dedikuar për këtë proces), pasi beson se monitorimi i zbatueshmërisë së ligjit, është një mekanizëm shumë i mirë për rritjen e përgjegjshmërisë në autoritetet kontraktore dhe rrjedhimisht dhe për rritjen e efikasitetin të sistemit të prokurimit publik në përgjithësi. Të dhëna më të detajuara mbi procesin e monitorimit do të jepen në vijim të kësaj analize.

Gjatë vitit 2015, një sfidë për APP ka qenë dhe përfaqësimi në çështje gjyqësore, ku ka qenë palë, kjo sidomos për shkak të numrit të lartë të vendimeve të APP të ankimuara në gjykatë. Megjithatë, treguesit e ardhur nga statistikat në këtë drejtim janë shumë pozitivë për veprimtarinë dhe vendimmarrjen e APP. Të dhëna të detajuara në këtë drejtim do të jepen më poshtë.

Në lidhje me procesin e vazhdueshëm të përmirësimit të prokurimit elektronik, APP, gjatë këtij viti ka punuar intensivisht për ngritjen e kapaciteteve të sistemit, si në pjesën operacionale, ashtu dhe në atë të arkivës. Sfida më e madhe e APP në këtë drejtim ka qenë menaxhimi i ngarkesës së sistemit për shkak të numrit shumë të lartë të procedurave të zhvilluara në të, numër i cili rritet ndjeshëm për shkak të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Një tjetër sfidë gjatë këtij viti ka qenë edhe trajnimi i autoriteteve kontraktore mbi zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, në kushtet kur numri i kërkesave për këto trajnime ka qenë shumë i lartë.

4. BASHKËPUNIMI I AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK ME INSTITUCIONE HOMOLOGE VENDASE DHE TË HUAJA, TË VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE INSTITUCIONE TË TJERA NDËRKOMBËTARE

4.1. BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE HOMOLOGE TË VENDEVE TË RAJONIT DHE TË BE-SË

Gjatë vitit 2015, APP ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me institucione homologe ndërkombëtare. Në këtë kuadër përfaqësues nga APP kanë marrë pjesë në takime ndërkombëtare, si dhe kanë pritur delegacione me përfaqësues të institucioneve homologe në rajon.

Sikurse është përmendur më sipër, një bashkëpunim shumë të rëndësishëm gjatë këtij viti APP ka vazhduar të ketë me SIGMA, një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian, financuar nga BE, me të cilën ka punuar ngushtësisht për hartimin e një Manuali për Marrëveshjen Kuadër dhe fillimin e punës për përafrimin e Direktivës për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjatë këtij viti, APP ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë dhe me përfaqësinë e Bankës Botërore në Shqipëri. Përveç pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme, të organizuara nga kjo e fundit, në vitin 2015 APP ka fituar dhe ka filluar punën për një projekt ku kërkohet asistencë për përcaktimin e treguesve për matjen e performancës në sistemin e prokurimit publik dhe përforcimin e transparencës së sistemit të prokurimit elektronik. Gjithashtu, gjatë këtij viti, APP ka bashkëpunuar me Bankën Botërore për t'i vënë në dispozicion të dhëna mbi sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, në funksion të një Raporti Vlerësimi mbi këtë sistem që do të përgatitet nga Banka Botërore gjatë vitit 2016.

4.2. BASHKËPUNIMI I APP ME INSTITUCIONE TË TJERA NË SHQIPËRI

Edhe gjatë vitit 2015, APP ka patur një bashkëpunim të ngushtë me institucione të pushtetit qendror dhe vendor brenda vendit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, nga APP janë dhënë sqarime dhe këshilla për këto institucione, sipas kërkesave, me qëllim zbatimin sa më korrekt të legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të koncesioneve dhe partneritetit publik privat dhe atij të ankandit publik.

Një bashkëpunim të ngushtë dhe intensiv, APP ka vazhduar të ketë dhe gjatë vitit 2015 me Ministrinë e Integritit. Në këtë kuptim, APP ka raportuar në mënyrë periodike pranë kësaj Ministrie mbi progresin e arritur në drejtim të zbatimit të angazhimeve që janë marrë me

nënshkrimin e MSA, në fushën e prokurimeve publike. Në këtë kuadër, janë realizuar takime të shpeshta me këtë Ministri, të cilat kanë patur si objektiv konsultimin e specialistëve me qëllim realizimin e objektivave në kuadër të integritetit.

Bashkëpunim të mirë gjatë vitit 2015, APP ka vijuar të ketë dhe me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), në bashkëpunim me të cilën ka realizuar disa trajnime për autoritetet kontraktore, me qëllim njohjen e tyre me kuadrin ligjor dhe përmirësimet e sistemit të prokurimit elektronik.

Një tjetër bashkëpunim intensiv gjatë vitit 2015, APP ka pasur me institucionet audituese, ku ndër më kryesorët ka qenë Kontrolli i Lartë i Shtetit, me qëllim evidentimin dhe penalizimin e shkeljeve të konstatuara gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit nga autoritete të ndryshme kontraktore.

Gjatë vitit 2015, në ushtrimin e detyrave të saj ligjore, APP ka vijuar bashkëpunimin edhe me institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik. Në bazë të dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik, KPP ka njoftuar APP në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim që ky vendim të pasqyrohet në sistemin e prokurimit elektronik për mosprocedimin e mëtejshëm nga ana e autoriteteve kontraktore. Gjithashtu, ky bashkëpunim evidentohet edhe në rastin e pasqyrit në sistemin e prokurimit elektronik të vendimeve të dhëna nga KPP, në përfundim të shqyrtimit të ankesave.

Gjatë këtij viti, dy institucionet kanë bashkëpunuar edhe për hartimin e një rekomandimi të përbashkët në lidhje me procedurën e prokurimit që ka objekt ofrimin e shërbimit të ruajtjes fizike, me qëllim udhëzimin e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

Të dy institucionet kanë bashkëpunuar edhe në kuadër të raportimeve në Ministrinë e Integritetit mbi detyrimet në këtë drejtim në fushën e prokurimit publik, në të gjitha ato raste ku raportimet janë kërkuar në nivel të Kapitullit 5 “Prokurimi Publik”.

5. TREGUES TË VEPRIMTARISË SË SEKTORIT JURIDIK PRANË DREJTORISË JURIDIKE DHE MONITORIMIT

Sektori Juridik e ka filluar veprimtarinë e tij, si sektor i mëvetshëm, në muajin Korrik 2015. Ky sektor u ngarkua me kryerjen e të gjitha detyrave të Drejtorisë, përveç detyrës së monitorimit. Veprimtaria e Drejtorisë Juridike dhe Monitorimit, në gjysmën e parë të vitit dhe e Sektorit Juridik në gjysmën e dytë të tij, është fokusuar kryesisht në hartimin e projektakteve nënligjore dhe udhëzimeve për unifikimin e praktikave në fushën e prokurimit publik, në dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, si dhe shqyrtimin e propozimeve për përjashtimin e shoqërive të ndryshme nga e drejta për të marrë pjesë në procedurat e prokurimeve publike apo procedurat e ankandeve.

Më konkretisht, gjatë vitit 2015, Sektori Juridik e përqëndroi veprimtarinë e tij në këto drejtime kryesore:

5.1. NDRYSHIMET NË KUADRIN LIGJOR

Gjatë vitit 2015, Sektori Juridik ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për përmirësimin e legjislacionit të prokurimit publik, legjislacionit të koncesioneve dhe partneritetit publik-privat, si dhe për nxjerrjen e një sërë udhëzimesh për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

Ky sektor ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në hartimin e Dokumentat Standarde të Tenderit për ti sjellë ato në përputhje me ndryshimet e pësuara në ligjin e prokurimit publik dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe gjithë udhëzimet e APP të përgatitura në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.

5.2. PRAKTIKAT E SHQYRTUARA PËR DHËNIE MENDIMESH, KËSHILLA APO UDHËZIMESH GJATË KËTJU VITI

Sektori Juridik, në zbatim të detyrave që i ngarkojnë legjislacioni në fushën e prokurimit publik, koncesioneve/ppp dhe ankandit publik, ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm praktikash, të cilat kanë pasur të bëjnë me dhënien e mendimeve, këshillave apo udhëzimeve në ndihmë të autoriteteve kontraktore, dhënien e mendimeve për projektvendime të ndryshme, udhëzime për unifikimin e praktikave, shqyrtimin e propozimeve të autoriteteve kontraktore për përjashtimin e subjekteve të ndryshme nga procedurat e prokurimit.

Asistenca e dhënë nga ky sektor është përqendruar në mirëzbatimin e rregullave të prokurimit dhe këshillimin ligjor për problemet e ndeshura gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik.

Një numër i konsiderueshëm kërkesash për mendim janë fokusuar në mënyrën e procedimit në rastin e aplikimit të Marrëveshjes Kuadër, si dhe problematikat e ndryshme të vërejtura në prokurimet me vlerë të vogël, të cilat që prej vitit 2013 realizohen nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike.

Në lidhje me disa probleme të ndeshura nga operatorët ekonomikë gjatë ofertimit në këtë lloj procedure prokurimi, nga ana e Sektorit juridik është punuar për hartimin e një rekomandimi për autoritetet kontraktore se si duhet të vendosin kriteret për kualifikim për këtë lloj procedure prokurimi sidomos në rastin e kërkesës për paraqitjen e mostrave të produkteve. Ky rekomandim është publikuar në faqen zyrtare të internetit të APP.

Gjatë vitit kalendarik 2015, ky sektor ka patur komunikime shkresore me institucione të ndryshme dhe kryesisht me: (i) Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore në lidhje me informacione të ndryshme të kërkuara nga ana e tyre mbi procedurat e prokurimit të kryera nga autoritete të ndryshme kontraktore, (ii) me operatorë të ndryshëm ekonomikë dhe (iii) me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë, mbi verifikimin e kërkuar për operatorë ekonomikë të caktuar nëse ka një vendim përjashtimi për to nga APP.

Konkretisht, numri total i praktikave të paraqitura në këtë sektor për mendim, sqarim apo informacione nga institucione të ndryshme, për çështje që lidhen me procesin e prokurimit publik, koncesioneve/PPP-ve, dhe ankandeve gjatë vitit 2015 është **260**.

Në formë tabelore këto të dhëna janë si më poshtë:

Kërkesa për dhënie mendimi/sqarim	Verifikime të kërkuara nga DSIK pranë Kryeministrisë	Kërkesa të paraqitura nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore
136	99	25

Gjithashtu, gjatë këtij viti, janë dhënë mendime dhe për projektvendime të ndryshme të iniciuara nga institucione të tjera, të cilat i janë përcjellë për mendim APP.

Gjatë vitit 2015, numri total i praktikave, për të cilat ky sektor ka dhënë mendime për projektvendime të ndryshme, **është 11**.

5.3. SHQYRTIMI I PROPOZIMEVE PËR PËRJASHTIMIN E OPERATORËVE EKONOMIKË

Një kompetencë tjetër ligjore e APP, që është ushtruar nëpërmjet këtij sektori gjatë vitit 2015, ka qenë dhe marrja në shqyrtim e propozimeve të autoriteteve kontraktore/operatorëve ekonomikë, për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga e drejta për të ofertuar në procedura prokurimi apo procedura ankandi për një periudhë të caktuar kohore.

Konkretisht, gjatë vitit 2015 u morën në shqyrtim **31 propozime për përjashtimin e operatorëve ekonomikë**, nga të cilat u fillua procedimi administrativ për përjashtimin nga procedurat e prokurimit për **11** operatorë ekonomikë.

Në përfundim të procedimit administrativ, është marrë vendimi për përjashtimin nga e drejta për të marrë pjesë në prokurime, për **6 (gjashtë)** operatorë ekonomikë.

Nga këta:

- **3 (tre)** Operatorë Ekonomikë janë përjashtuar për shkak të keqinformimit, nëpërmjet paraqitjes në tender të dokumentave, që përmbajnë të dhëna të rreme, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- **3 (tre)** Operatorë Ekonomikë janë përjashtuar për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas përcaktimeve të nenit 13/3/ç të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- **Për 5 (pesë)** operatorë ekonomikë është marrë vendim për mospërjashtim, pasi është arritur në përfundimin se nuk plotësohen kushtet e nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- **Për 4 (katër)** operatorë ekonomikë, është marrë vendim për pezullimin e procedimit administrativ, deri sa gjykata të shprehet me vendim përfundimtar, për një çështje të lidhur;
- **Për 1 (një)** operator ekonomik, procedimi është ende në proces;
- **Për 15 (pesëmbëdhjetë)** kërkesa në të cilat propozohej përjashtimi i operatorëve ekonomikë, kërkesa e paraqitur është konsideruar me dokumentacion të

pamjaftueshëm dhe e paargumentuar për fillimin e procedimit administrativ, dhe iu është kërkuar propozuesve të plotësojnë kërkesat.

TOTALI				
31 kërkesa për përjashtim				
Vendime përjashtimi	Vendime mos përjashtimi	Procedime administrative të pezulluara	Procedime administrative në proces	Kërkesa të paplota
6	5	4	1	15

4 (katër) nga vendimet e APP për përjashtim janë ankimuar nga pala e prekur nga vendimi, në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, Tiranë, nga të cilat:

- **për 2 (dy)** operatorë ekonomikë është pranuar pjesërisht kërkesë padia, duke u ulur dënimin nga 3 vjet në 1 vit.
- **për 2 (dy)** operatorë ekonomikë është rrëzuar kërkesë padia.

Ankimuar në gjykatë	Rrëzuar kërkesë padia	Pranuar pjesërisht kërkesë padia
4 vendime të APP	2 vendime	2 vendime (duke ulur masën e dënimit nga 3 në 1 vit)

5.4. PËRFAQËSIMI NË PROCESET GJYQËSORE

Gjatë vitit 2015, APP është përfaqësuar në proceset gjyqësore si palë e paditur kryesisht nga operatorë ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në prokurimet publike apo zyrtarët e autoriteteve kontraktore të dënuar me gjobë në përfundim të procesit të monitorimit.

Sikurse është cilësuar dhe në fillim të kësaj analize vjetore, përfaqësimi në gjykatë për të mbrojtur vendimet e APP, ka qenë një sfidë, për shkak të numrit shumë të lartë të çështjeve gjyqësore ku APP ka qenë e thirrur si palë ndërgjyqëse.

Gjithsej në vitin 2015, nga APP janë ndjekur 115 çështje gjyqësore, nga të cilat 73 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, 36 çështje në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë dhe 6 çështje në Gjykatën e Lartë.

Çështje gjyqësore në total	Në Gjykatën Admin. Shk. e Parë	Në Gjykatën Admin. Apel	Në Gjykatën e Lartë
115	73	36	6

Nga 73 çështjet gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, janë **përfunduar** 68 çështje dhe janë në proces 5 prej tyre.

Nga 73 çështjet gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë:

- 7 çështje janë kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë;
- 63 çështje janë për vendime të APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit;
- 3 çështje janë për marrëdhënie pune.

Çështje gjyqësore në Gjykatën Admin. Shk. e Parë	Kundër vendimeve të APP për përjashtimin e op. ek.	Kundër vendimeve të APP për dënimin me gjobë	Kundër vendimeve të APP për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës
73	7	63	3

Nga **7 çështjet** gjyqësore kundër vendimeve të APP për përjashtimin e operatorëve ekonomikë:

- për 1 çështje është pranuar kërkesë padia;
- për 2 çështje është rrëzuar kërkesë padia;
- për 4 çështje është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesë padisë duke ulur masën e dënimit për përjashtimin nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik në 1 (një) vit.

Çështje kundër vendimeve të përjashtimit	Pranuar kërkesë padia	Rrëzuar kërkesë padia	Pranimi pjesërisht i kërkesë padisë
7	1	2	4

Nga 63 çështjet gjyqësore kundër vendimeve të APP për dënime me gjobë, në përfundim të procesit të monitorimit, 58 çështje kanë përfunduar në shkallë të parë, dhe konkretisht Gjykata ka vendosur:

- në 17 çështje pranimin e kërkesë padisë;
- në 31 çështje rrëzimin e kërkesë padisë;
- në 4 çështje mospranimin e kërkesë padisë;
- në 6 çështje është vendosur pushimi;
- Ndërkohë, 5 çështje janë ende në proces.

Çështje kundër vendimeve të dënimit me gjobë	Pranuar kërkesë padia	Rrëzuar kërkesë padia	Mospranimi i kërkesë padisë	Pushimi i çështjes	Në proces
63	17	31	4	6	5

Për 3 çështjet gjyqësore kundër APP, me objekt marrëdhëniet e punës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë ka dhënë vendimin përfundimtar duke vendosur:

- për 1 çështje pranimin e kërkesë padisë dhe
- për 2 çështjet e tjera rrëzimin e kërkesë padisë.

Çështje kundër vendimeve për marrëdhënie pune	Pranuar kërkesë padia	Rrëzuar kërkesë padia
3	1	2

Nga 58 vendimet gjyqësore për çështjet e përfunduara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, 36 vendime janë apeluar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, nga të cilat:

- 17 vendime janë apeluar nga APP dhe
- 19 vendime janë apeluar nga pala tjetër ndërgjyqëse.

Vendime gjyqësore të apeluara	Apeluar nga APP	Apeluar nga pala tjetër ndërgjyqëse
36	17	19

Nga 36 çështjet e apeluara në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, janë përfunduar me vendim të formës së prerë 10 çështje, dhe janë ende në proces 26 çështje.

Vendime gjyqësore të apeluara	Përfunduar me vendim të formës së prerë	Në proces
36	10	26

Përveç çështjeve gjyqësore pranë gjykatave administrative, sikurse analizuar më sipër, APP është palë në **6 çështje** në Gjykatën e Lartë, të cilat janë ende në proces.

Në rastin e fletëthirrjeve për t'u paraqitur si palë ndërgjyqëse në gjykatat administrative në rrethe, APP iu është drejtuar këtyre të fundit me kërkesë për shpalljen e moskompetencës, sipas ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

6. MONITORIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Sektori i Monitorimit e ka filluar veprimtarinë e tij, si sektor i mëvetshëm i Drejtorisë, në muajin Korrik 2015. Ky sektor u ngarkua specifikisht me detyrën e monitorimit, si dhe shqyrtimit të raporteve të auditimit të sjella nga institucionet e tjera, sipas përcaktimeve të LPP. Veprimtaria e Drejtorisë Juridike dhe Monitorimit, në gjysmën e parë të vitit dhe e Sektorit të Monitorimit në gjysmën e dytë të tij, është fokusuar kryesisht në zbatimin të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit.

6.1. MONITORIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT NGA APP

Një ndër detyrat kryesore të Drejtorisë Juridike dhe Monitorimit gjatë vitit 2015 ka qenë verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit.

Monitorimi i procedurave të prokurimit nga APP është iniciuar nga kjo e fundit, nga denoncimet e ardhura drejtëpërsëdrejti në APP, si dhe nga denoncimet e të tretëve në portalin www.stopkorrupsionit.al.

Mbi këtë bazë, në funksion të përmbushjes së këtij detyrimi ligjor, gjatë vitit 2015 janë hartuar dhe zbatuar dy Plane Monitorimi, ku janë përfshirë procedura prokurimi të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore.

Plani i parë i monitorimit ka përfshirë procedurat e prokurimit të zhvilluara në periudhën Shtator-Dhjetor 2014 dhe është realizuar në 6-mujorin e parë të vitit 2015.

Si kriter për përzgjedhjen e procedurave të prokurimit objekt monitorimi, është marrë në konsideratë kryesisht lloji i procedurës së prokurimit dhe shkalla e transparencës që kjo lloj procedure ofron. Konkretisht, “procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, si një procedurë e veçantë prokurimi, relativisht jo-transparente, që përdoret në rrethana të caktuara, të parashikuara në dispozitat ligjore të prokurimit publik, është një nga procedurat e monitoruara më tepër nga APP.

Duke qenë se, procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është një procedurë që nuk kërkon publikim, pra nuk lejon pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë, përdorimi i saj nga autoritetet kontraktore mund të bëhet abuziv dhe të çojë në shmangien e konkurrencës ose në diskriminim të kandidatëve.

Në këtë kuadër, nga të dhënat e nxjerra nga Buletini i Njoftimeve Publike, (*njoftimet e kontratave të nënshkruara të publikuara në këtë buletin, në periudhën Shtator – Dhjetor 2014*), duke marrë për bazë fondin limit, natyrën e objektit të prokurimit, kundërshtimet e paraqitura nga operatorët ekonomikë në APP, si dhe faktin që i njëjti autoritet kontraktor ka zhvilluar këtë lloj procedure prokurimi në vazhdimësi, janë përfshirë në planin e monitorimit 14 procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të zhvilluara nga 5 autoritete kontraktore.

Gjithashtu, janë përzgjedhur për monitorim dhe 19 procedura prokurimi konkurruese të zhvilluara nga 19 autoritete të ndryshme kontraktore, duke marrë për bazë vlerën e fondit limit, natyrën e objektit të prokurimit, faktin që oferta fituese është afër ose e barabartë me fondin limit të procedurës, si dhe ankimet e operatorëve ekonomikë në APP.

Plani i dytë i monitorimit është hartuar në kuadër të verifikimit të denoncimeve të ndryshme të paraqitura në APP dhe portalin www.stopkorrupsionit.al.

Në këtë plan janë përfshirë 18 procedura prokurimi të zhvilluara nga 15 autoritete të ndryshme kontraktore dhe është realizuar në 3 mujorin e fundit të vitit 2015.

Përveç procedurave të prokurimit, të monitoruara në kuadër të planeve të monitorimit, nga APP është verifikuar zbatimi i ligjshmërisë edhe për 16 procedura prokurimi, të zhvilluara nga 16 autoritete të ndryshme kontraktore, të cilat janë përcjellë për monitorim nga organe të tjera si, Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit në Kryeministri, Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të Paluajtshme, KPP apo janë denoncuar në APP.

Si rezultat, gjatë vitit 2015 APP ka nisur monitorimin në Total për **67** procedura prokurimi, të zhvilluara nga 55 Autoritete Kontraktore.

Në përfundim të procesit të monitorimit, në rastet kur janë konstatuar shkelje të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, në varësi të kohës së kryerjes së procedurës së prokurimit (duke pasur në konsideratë rregullimin ligjor në kohën e kryerjes së procedurës), llojit të shkeljes, fondit limit në dispozicion të procedurës së prokurimit, si dhe pasojës së ardhur, APP ka marrë vendim për dënim me gjobë, ose propozim për marrjen e masës disiplinore, ndaj personave përgjegjës.

Në rastet kur është konstatuar se, procedura e prokurimit, objekt monitorimi, ka qenë në proces kontrolli nga organe të tjera audituese (si KLSH, FSDKSH apo audite të brendshme të institucioneve) është pezulluar hetimi administrativ. Në këto raste (dhe konkretisht për 6 procedura prokurimi) është vendosur se APP do të vlerësojë dhe gjykojë mbi gjetjet përfundimtare të organit auditues për ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor në kryerjen e procedurave të prokurimit, përfshirë dhe procedurat objekt monitorimi.

Gjithashtu, ka patur raste, kur gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se procedura e prokurimit, objekt monitorimi nuk është zhvilluar sipas procedurave të parashikuara nga LPP (ligj me të cilin APP ushtron kompetencat e saj), por akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Konkretisht kanë rezultuar 6 raste (procedura prokurimi) të tilla. Në këto raste është vendosur pushimi i hetimit administrativ.

Llojet e procedurave të prokurimit të monitoruara nga APP, për lehtësi paraqiten në tabelën më poshtë:

Lloji i procedurës së prokurimit	Numri i procedurave të monitoruara
Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit	20
Procedurë e hapur	30
Kërkesë për propozim	3
Procedura prokurimi me vlerë të vogël	14

Në procedurat e monitoruara, të cilat kanë rezultuar me shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, janë marrë masat e mëposhtme:

Gjoha

Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	10
Anëtar i Njësisë së Prokurimit	10
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	22
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	10
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	1

Masa Disiplinore

Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Anëtar i Njësisë së Prokurimit	18
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	6
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	3
Anëtar i Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël	6

Gjatë monitorimeve të kryera nga APP janë konstatuar shkelje të ndryshme të dispozitave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, në varësi të llojit të procedurës së prokurimit të monitoruar.

Sa i takon procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, synimi i monitorimit të kësaj lloji procedure, ka qenë: (i) identifikimi i arsyeve që çojnë një autoritet kontraktor në përzgjedhjen e kësaj lloji procedure (*duke qenë se zhvillimi i saj nuk bëhet në mënyrë transparente dhe konkurruese*), (ii) kontrolli i përmbushjes dhe zbatueshmërisë së kushteve të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik për këtë rast, si dhe (iii) parandalimi i përzgjedhjes së gabuar të kësaj lloji procedure në të ardhmen.

Gjetja kryesore e APP në monitorimin e kësaj lloji procedure, është që në shumicën e rasteve autoritetet kontraktore kanë përdorur këtë lloji procedure me pretendimin se janë ndodhur në kushte emergjente për objektin e prokurimit, por nuk justifikojnë rrethanat e paparashikuara që i çojnë ato në pamundësi për të planifikuar në kohë nevojat e tyre, me qëllim përmbushjen e këtyre të fundit nëpërmjet procedurave konkurruese, sipas parashikimeve ligjore.

Në rastet kur, AK ka pasur mundësi të parashikojë në kohë nevojën, por me mosveprimet e tij, ka sjellë “krijimin e një situatë emergjente”, përzgjedhja e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është konsideruar në shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik në fuqi.

Zyrtarët e gjetur fajtor për këtë lloji shkelje janë dënuar individualisht, kryesisht me gjobë që varion nga 50,000 në 1,000,000 lekë, si një nga masat administrative të parashikuara nga LPP, për këtë rast.

Përveç përzgjedhjes së gabuar të kësaj lloji procedure, sikurse kemi analizuar më sipër, një tjetër shkelje e konstatuar nga APP ka qenë lidhja e kontratave afatgjata, ndërkohë që legjislacioni në fuqi, përcakton në mënyrë të qartë mundësinë e përdorimit të kësaj procedure, vetëm për të zgjidhur situatat emergjente, duke ndaluar shprehimisht lidhjen e kontratave afatgjata.

6.2. SHQYRTIMI I RAPORTEVE AUDITUESE

Veprimtaria e Drejtorisë gjatë vitit 2015 është fokusuar edhe në shqyrtimin e raporteve të kontrollit të institucioneve audituese, (KLSH, FSDKSH, Audite të brendshme të institucioneve apo vendime të KPP) ku janë pasqyruar gjetjet për procedurat e prokurimit të audituara.

Shkeljet kryesore të evidentuara më së shumti gjatë shqyrtimit të këtyre raporteve konsistojnë në: (i) mos përlogaritjen e fondit limit në njërën prej mënyrave të parashikuara nga Rregullat e Prokurimit Publik apo mosdokumentimin e kësaj përlogaritje, (ii) hartimin e kriterëve kufizues të pranimit, jo në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, si dhe (iii) vlerësim të gabuar të ofertave të paraqitura.

Në përfundim të shqyrtimit të raporteve audituese dhe kundërshtimeve përkatëse të personave përgjegjës, për shkeljet e konstatuara janë vendosur gjoba, si dhe janë propozuar masa disiplinore ndaj personave përgjegjës, si më poshtë:

Gjoba:

Raportet e Auditit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
KLSH	11
Audit i Brendshëm	10
FSDKSH	6
Vendimet e KPP	4
Totali	31

Nisur nga roli i zyrtarit në procedurë, gjobat rezultojnë si më poshtë:

Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	10
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	8
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	20
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	12
Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël	1

Masa disiplinore të propozuara:

Raportet e Auditit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
KLSH	15
Audit i Brendshëm	15
FSDKSH	9
Vendimet e KPP	6
Totali	45

Nisur nga roli i zyrtarit në procedurë, masat disiplinore rezultojnë të jenë propozuar si më poshtë:

Roli i zyrtarit	Numri i Autoriteteve Kontraktore
Titullar i Autoritetit Kontraktor	10
Anëtar i Njesisë së Prokurimit	37
Anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave	16
Anëtar i Grupit për Përlllogaritjen e Fondit Limit	1
Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël	7

6.3. MONITORIME PËR PROCEDURA KONCESIONI

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve monitoruese, gjatë vitit 2015 është verifikuar zbatimi ligjshmërisë në një procedurë koncesioni, ku për shkeljet e konstatuara janë vendosur gjoba ndaj personave përgjegjës (konkretisht për 8 persona).

7. TREGUESIT E VEPRIMTARISË PËR DREJTORINË E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PUBLIKIMEVE

7.1. SEKTORI I PUBLIKIMEVE

Sektori i Publikimeve gjatë vitit 2015 ka publikuar në total 52 Buletine të Njoftimeve Publike me një numër faqe në total prej 19.097, ose mesatarisht 367 faqe për javë.

Përveç punës për përmbledhjen e informacionit për publikimin e Buletinit të Njoftimeve Publike punonjësit e ngarkuar me kryerjen e publikimit kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në miratimin e njoftimeve të kontratave të hedhura nga Autoritetet Kontraktore, me qëllim publikimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik. Ky publikim kryhet ditën e nesërme të punës në Sistemin e Prokurimit Elektronik, sikurse e kërkon legjislacioni i prokurimit publik në fuqi dhe në Buletinin vijues.

Konkretisht, gjatë vitit 2015 janë miratuar për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike:

7.1.1. Njoftime për Procedura

- 4630 Njoftime Kontratash të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit të rishpallura;
- 34 Njoftime për Marrëveshje Kuadër;
- 4,183 Njoftime Fituesi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit;
- 24 Njoftime Fituesi për Marrëveshje Kuadër;
- 5,677 Njoftime Kontratash të Nënshkruara;
- 2,706 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake;
- 139 Njoftime Kontratash të Nënshkruara brenda Marrëveshjeve Kuadër;

- 657 Njoftime Anullimi të koordinuara dhe me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit.
- 1,950 Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për pezullimin e procedurave të prokurimit, duke marrë kështu rolin e kontrolluesit dhe monitorimit të respektimit të afateve të ankimit në procedurat e prokurimit. Gjatë vitit 2015 është ndjekur ky zbatim i rreth 690 procedura prokurimi dhe vlen të cilësohet se në total janë rreth 1380 vendime pezullimi, lejimi për vazhdim si dhe 570 vendime të ndërmjetme.

7.1.2. Njoftime për Ankande Publike

- 683 Njoftime për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 220 Njoftime Fituesish për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 83 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 179 Njoftime Anullimi për Ankandet publike të zhvilluara nga Autoritetet Shitëse;
- 155 Njoftime Ankandesh për efekt të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- 38 Njoftime për qera.

7.1.3. Njoftime për Koncesione/Partneritet Publik Privat

- 15 Njoftime Kontratash për Procedura Koncesioni;
- 11 Njoftime Fituesish për Procedura Koncesioni;
- 4 Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Procedura Koncesioni;
- 150 Njoftime për Procedura konkurruese për dhënie leje minerare;
- 1,285 Njoftime të tjera.

Gjithashtu, gjatë vitit 2015 janë përpunuar rreth 3,500 regjistra, për parashikimin e prokurimeve, realizimin e tyre dhe ndryshimet gjatë vitit nga Autoritetet Kontraktore, në funksion të përpunimit të të dhënave dhe nxjerrjes së statistikave përkatëse.

7.2. STATISTIKA NË LIDHJE ME NUMRIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, KONCESIONEVE/PPP DHE ANKANDIT PUBLIK, TË SHPALLURA GJATË VITIT 2015

7.2.1. Statistika për procedurat e prokurimit të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik

Në këtë pjesë të analizës vjetore do të pasqyrohen dhe interpretohen të dhënat mbi numrin e procedurave të prokurimit publik mbi vlerën 800.000 mijë lekë, të cilat janë shpallur për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik. Gjithashtu, në këtë pjesë do të pasqyrohen dhe të dhënat respektive për numrin e njoftimeve të fituesve dhe numrin e njoftimeve të kontratave të nënshkruara.

7.2.1.1. Statistika sipas Njoftimit të kontratës

Numri total i njoftimeve të kontratave të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2015 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP është **4,630** (658 më pak se në vitin 2014).

Më poshtë pasqyrohet në mënyrë të detajuar numri i tyre sipas llojit të procedurës së publikuar.

Njoftime Procedurash Janar-Dhjetor 2015					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	168	Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi		Shërbim Konsulence dhe Konkurs Projektimi	
E hapur Ndërkombëtare	4	E hapur Ndërkombëtare	5	E hapur Ndërkombëtare	

Procedurë e hapur lokale	411	Procedurë e hapur lokale	588	Procedurë e hapur lokale	534
Kërkesë për Propozim	850	Kërkesë për Propozim	1,429	Kërkesë për Propozim	635
Procedurë e kufizuar lokale	1	Procedurë e kufizuar lokale		Procedurë e kufizuar lokale	
Negocim me Njoftim		Negocim me Njoftim	5	Negocim me Njoftim	
TOTALI	1,434	TOTALI	2,027	TOTALI	1,169

7.2.1.2. Statistika sipas llojit të procedurave

Në formë tabelore, të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, të ndara sipas llojit të procedurës, të zhvilluara në sistemin e prokurimit elektronik për vitin 2015, dhe fondet limite përkatëse, janë si më poshtë:

Numri total i procedurave të shpallura të ndarë sipas llojit të procedurave për Periudhën Janar-Dhjetor 2015	
Nr.Total i Procedurave të shpallura	4,630
Fondi total limit i procedurave të shpallura	90,702,378,325
Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi nr	168
Shërbim konsulence dhe konkurs projektimi në vlerë	2,391,700,910
I hapur ndërkombëtar nr	9
I hapur ndërkombëtar në vlerë	5,138,742,047
I hapur lokal nr	1,533
I hapur lokal në vlerë	74,300,872,786
Kërkesë për propozim nr	2,914
Kërkesë për propozim vlerë	8,846,410,483
I kufizuar lokal nr	1
I kufizuar lokal vlerë	4,240,000

Negocim me shpallje	5
Negocim me shpallje vlerë	20,412,099

Nga analizimi i të dhënave dhe vlerave, rezulton se megjithëse numri i procedurave të shpallura në vitin 2015 është më i ulët se në vitin 2014 (658 më pak), numri i vlerës totale të fondit limit të shpallur në vitin 2015 është konsiderueshëm më i lartë se sa ai i vitit 2014 (30, 596, 708 lekë më shumë).

7.2.1.3. Statistika për njoftimet e fituesit

Numri total i njoftimeve të fituesit të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2015 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP është **4269** (336 më pak se në vitin 2014).

Në formë tabelore, të dhënat për procedurat e prokurimit elektronik, të ndara sipas llojit të procedurës, dhe fondeve përkatëse, të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues në sistem gjatë vitit 2015 janë si më poshtë:

Njoftime Fituesish Janar-Dhjetor 2015					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
E hapur Ndërkombëtar e	11	E hapur Ndërkombëtar e	18	E hapur Ndërkombëtar e	
Procedurë e hapur lokale	385	Procedurë e hapur lokale	784	Procedurë e hapur lokale	455
Kërkesë për Propozim	653	Kërkesë për Propozim	1,369	Kërkesë për Propozim	505
Shërbim Konsulence	88	Shërbim Konsulence		Shërbim Konsulence	

dhe Konkurs Projektimi		dhe Konkurs Projektimi		dhe Konkurs Projektimi	
Procedurë e kufizuar lokale	1	Procedurë e kufizuar lokale		Procedurë e kufizuar lokale	
TOTALI	1,138	TOTALI	2,171	TOTALI	960

Ndërkohë, njoftimet e fituesit sipas llojit të procedurës dhe vlerave respektive me të cilat janë shpallur dhe janë fituar procedurat paraqiten si më poshtë:

Të dhëna për procedurat e prokurimit të zhvilluara dhe të përfunduara me fitues

Janar-Dhjetor 2015

Llojet e procedurave	Nr.Total i procedurave	Fondi limit total i prokuruar	Fondi total i ofruar(tenderuar)	% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondit limit të prokuruar	Fondi total i kursyer	% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar
Procedurë e hapur ndërkombëtar e (njoftim fituesi)		5,606,097,399	5,140,624,552	0.916970253	465,472,847	0.083029747
Procedurë e hapur lokal (njoftim fituesi)	1624	56,727,227,138	51,542,068,655	0.908594889	5,185,158,483	0.091405111
Kërkesë për propozim (njoftim fituesi)	2527	6,370,909,808	5,706,229,930	0.895669551	664,679,878	0.104330449
Shërbim konsulence, konkurs projektimi (njoftim fituesi)	88	1,981,789,233	1,853,956,475	0.93549629	127,832,758	0.06450371
I Kufizuar Lokal	1	125,000,000	81,629,165	0.65303332	43,370,835	0.34696668
Totali	4269	70,811,023,577	64,324,508,777	0.908396822	6,486,514,800	0.091603178

7.2.1.4. Statistika për kontratat e nënshkuara

Numri total i njoftimeve të kontratave të nënshkuara të procedurave të prokurimit të publikuara gjatë vitit 2015 në sistemin e prokurimit elektronik, sipas llojeve të kontratave, shërbim, mall, punë, në faqen zyrtare të APP është **5750** (661 më pak se në vitin 2014). Njoftimet e kontratave të nënshkuara sipas llojit të procedurave dhe tipit të kontratave paraqiten si më poshtë:

Njoftime Kontratash të nënshkuara Janar-Dhjetor 2015					
Shërbime		Mallra		Punë Civile	
Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave	Lloji i Procedurës	Numri i njoftimeve të procedurave
Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	75	Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi		Shërbim Konsulencë dhe Konkurs Projektimi	
E hapur Ndërkombëtare	7	E hapur Ndërkombëtare	226	E hapur Ndërkombëtare	
Procedurë e hapur lokale	351	Procedurë e hapur lokale	2,206	Procedurë e hapur lokale	451
Kërkesë për Propozim	624	Kërkesë për Propozim	1,293	Kërkesë për Propozim	516
Procedurë e kufizuar lokale	1	Procedurë e kufizuar lokale		Procedurë e kufizuar lokale	
TOTALI	1,058	TOTALI	3,725	TOTALI	967

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelat e mësipërme, rezulton se numri total i procedurave të shpallura në sistemin elektronik janë **4,630**, ndërkohë që numri i procedurave të fituara (të cilat maten me njoftimet e fituesve të publikuar në sistem) është **4,269**. Diferenca midis numrit të procedurave të shpallura me ato të përfunduara me njoftim fituesi në sistem, shpjegohet me faktin se disa nga procedurat e shpallura janë anuluar (për arsye të ndryshme të cilat do të analizohen më poshtë), ose janë procedura të cilat janë shpallur në fund të vitit 2015 dhe nuk janë përfunduar ende me njoftimin e fituesit (janë në proces).

Gjithashtu, po nga tabelat më sipër rezulton se numri i kontratave të nënshkuara (**5,750**) është më i madh se numri i njoftimeve të kontratave fillestare (**4,630**) dhe më i madh se numri i fituesve (**4269**). Kjo diferencë shpjegohet me disa argumenta. Së pari, disa prej njoftimeve të kontratave të nënshkuara i referohen procedurave të prokurimit të shpallura dhe të zhvilluara në vitin 2014 (dhe vetëm kontrata e nënshkuar është publikuar në vitin 2015). Së dyti, disa prej procedurave janë zhvilluar në mënyrë të përqëndruar (nga Organi Qendror Blerës, ose Ministri të ndryshme që kanë shërbyer si organ qendror për institucionet e veta të varësisë), dhe në këtë rast, fituesi është një, kurse kontrata të nënshkuara janë aq sa është dhe numri i institucioneve përfituese nga kjo procedurë. Së treti, disa prej procedurave janë procedura me lote dhe për rrjedhojë rezulton një procedurë e shpallur dhe disa fitues (sipas loteve) dhe disa kontrata të nënshkuara (sipas loteve).

7.2.1.5. Statistika mbi përqindjen e kursyer

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për numrin e procedurave të prokurimit publik, fondin limit përkatës, numrin e procedurave të fituara me fondin limit dhe fondin e ofruar përkatës, si dhe kursimin në %, të zhvilluara në sistemin elektronik gjatë vitit 2015.

Procedura prokurimi të zhvilluara në sistemin elektronik-Periudha Janar-Dhjetor 2015	
Nr.Total i procedurave të publikuara	4,630
Fondi total limit i procedurave të publikuara	90,702,378,325
Nr.Total i procedurave të cilat kanë vazhduar	3,973
Fondi total limit i proc.të cilat kanë vazhduar	84,302,774,722
Nr.Total i procedurave të papërfundura (anulluar,etj)	657
Fondi total limit i proc.të papërfundura (anulluar,etj)	6,399,603,603
Nr.Total i Proc.të fituara	4,269
Fondi total limit	70,811,023,577
Fondi total i prokuruar	64,324,508,777

% që zë Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	90.8%
Fondi total i kursyer	6,486,514,800
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	9.2%

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën më sipër, rezulton se nga 4,630 procedurat e shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, 657 prej tyre janë anuluar.

Për të kuptuar dhe analizuar drejt këtë shifër (e cila në pamje të parë është relativisht e lartë, po të kemi në konsideratë numrin total të procedurave të shpallura), duhet të kemi në konsideratë faktin që duke qenë se këto procedura zhvillohen në formë elektronike, ka dy arsye kryesore anulimi: i) arsye teknike; dhe ii) arsye ligjore.

Ndër arsyet teknike përmendim kryesisht gabimet në plotësimin/kryerjen e hapave në sistemin e prokurimit elektronik.

Ndër arsyet ligjore që çojnë në anulimin e procedurave përmendim vendimet e anulimit nga Komisioni i Prokurimit Publik, mungesë konkurrence gjatë zhvillimit të procedurave, anulimeve për shkak të mbylljes së vitit buxhetor, etj.

Një rast tjetër që vlen të përmendet në funksion të kësaj analize është dhe rasti kur shpallet një procedurë me lote dhe anulohen një ose disa lote të saj. Në këtë rast, numri i procedurës së shpallur është vetëm një, ndërkohë që për këtë procedurë të shpallur do të numërohen si procedura të anuluar çdo lot i mëvetshëm, nëse është rasti.

Gjithsesi, ajo që vlen të theksohet është se numri i procedurave të anuluar gjatë vitit 2015 (657) është më pak se gjysma e numrit të procedurave të anuluar gjatë vitit 2014 (1409). Kjo shifër mund të lexohet si një tregues i ngritjes së kapaciteteve të autoriteteve kontraktore, si në drejtim të punës në sistemin elektronik të prokurimit (duke minimizuar kështu anulimet për shkak të gabimeve teknike), ashtu edhe në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit të procedurës në përputhje me legjislacionin në fuqi (duke ulur kështu numrin e procedurave të anuluar për shkak të problemeve ligjore të konstatuara në procedurë).

Kjo statistikë është gjithashtu dhe një tregues i punës së bërë nga APP për ngritjen e kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të zhvilluara gjatë vitit 2015.

Një tregues tjetër që duhet të analizohet nga tabela e mësipërme është diferenca e numrit të procedurave që kanë vazhduar në vitin 2015 (3973) me numrin e procedurave të përfunduara me njoftim fituesi në vitin 2015 (4269). Kjo diferencë vjen për shkak të faktit se në numrin e procedurave të përfunduara me njoftim fituesi përfshihen dhe ato procedura që kanë filluar në vitin 2014, por njoftimi i fituesit është shpallur në vitin 2015. I njëjti arsytim vlen dhe për diferencën në vlerat e fondeve respektive.

7.2.2. Të dhëna mbi procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit

Përveç procedurave të prokurimit publik të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, sipas legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, autoritetet kontraktore, nëse ndodhen në kushtet e parashikuara nga ligji, mund të kryejnë dhe procedura prokurimi me negociim pa shpallje paraprake.

Të dhënat për procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake, për vitin 2015 paraqiten si më poshtë:

Periudha Janar-Dhjetor 2015 Kontratat me Procedurë Negocim pa Shpallje Paraprake të Njoftimit	
Nr.Total i procedurave të fituara	2,706
Fondi total limit i prokuruar	8,734,240,209
Fondi total i ofruar pa tvsh	8,611,242,851
% që zë fondi total i ofruar ndaj fondit limit të prokuruar	98.6%
Fondi total i kursyer	122,997,358
% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit të prokuruar	1.4%

Sikurse shihet dhe nga tabela, gjatë vitit 2015 janë zhvilluar **2,706** procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Për të analizuar dhe lexuar drejt këtë të dhënë, duhet të kemi në konsideratë këto situata:

- Pothuajse të gjitha autoritetet kontraktore kryejnë procedura negociim pa shpallje, për një vlerë deri në 20% të kontratës së fundit, për të përmbushur nevojat e fillim vitit, një mundësi kjo e rregulluar dhe lejuar nga legjislacioni në fuqi.
- Përdorimi i kësaj procedure bëhet i domosdoshëm edhe në kushtet kur krijohen situata emergjente (sidomos për mallra dhe shërbime të domosdoshme, si ushqime, shërbime pastrimi etj) “të stimuluar” nga legjislacionet e tjera dhe sidomos ai për buxhetin. Edhe gjatë këtij viti, në bazë të akteve të nxjerra në zbatim të legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor, nuk u lejua fillimi i një procedure prokurimi në rast se nuk ka kaluar buxheti përkatës, në llogarinë e Autoritetit Kontraktor (e konkretizuar kjo me kërkesën për të vulosur Urdhrin e Prokurimit në degën përkatëse të Zyrës së Thesarit). Në këtë situatë, lidhja e një kontrate nga një procedurë konkurruese prokurimi nuk mund të realizohet minimalisht përpara muajit Mars të një viti (nga praktika e deritanishme për shkak edhe të afateve të ankimit kjo periudhë shkon në muajt Prill-Maj të vitit).

Në këto kushte, autoritetet kontraktore (pasi kanë ezauruar dhe procedurat me negociim pa shpallje për nevojat e fillim vitit, sikurse analizuar më sipër) ndodhen përsëri në “situatë emergjente” për mallra dhe shërbime të domosdoshme, situatë që i çon në përdorimin e procedurës negociim pa shpallje.

Theksojmë se, në ndryshim nga legjislacioni buxhetor, legjislacioni i prokurimit e lejon fillimin e procedurës së prokurimit që me miratimin e buxhetit (pra pa pasur nevojë që buxheti të ketë kaluar në llogarinë e AK-së) deri në shpalljen e fituesit dhe nuk lejon lidhjen e kontratës pa kaluar buxheti respektiv në llogarinë e AK-së, duke mos u bërë pengesë administrative për zhvillimin e procedurës konkurruese. Ky lejim është bërë pikërisht për të fituar kohë me zhvillimin e procedurave, duke shmangur kështu në maksimum të gjitha situatat kur një autoritet kontraktor mbetet i pambuluar me kontrata për nevojat e tij të domosdoshme dhe të vazhdueshme.

- Një arsye tjetër e “stimulimit” të procedurave me negociim pa shpallje paraprake, vazhdon të jetë zgjatja e procedurave të prokurimit, sidomos në rastet kur ka një ankesë në shkallë të dytë administrative, Komisionin e Prokurimit Publik. Në disa prej rasteve të monitoruara nga APP, justifikimi i autoriteteve kontraktore për përdorimin e kësaj procedure ka qënë mospërfundimi i procedurës konkurruese, për shkak të shqyrtimit të ankesës në KPP.

- Arsye tjetër e shpeshtë për përdorimin e kësaj procedure, e lidhur kjo me objektet e prokurimit që mbulohen nga Organi Qendror Blerës, janë nevojat e pambuluara për shkak të kohës që duhet për zhvillimin e një procedure prokurimi nga OQB, e cila nga praktika e deri tanishme, nuk përfundon më parë se muaji Prill-Maj i vitit.

Në funksion të analizës së shkaqeve që çojnë në përdorimin e procedurës negociim pa shpallje paraprake, sikurse parashtruar më sipër, shërbejnë të dhënat e pasyruara në tabelën e mëposhtme, nga ku evidentohet qartë që gati 2/3 e të gjithë procedurave me negociim pa shpallje paraprake të zhvillura gjatë vitit 2015 (1836 nga 2706), janë realizuar vetëm në periudhën Janar-Mars të vitit 2015.

Periudha Janar-Mars 2015-Kontratat me Procedurë Negocim pa Shpallje Paraprake të Njoftimit	
Nr.Total i procedurave të fituara	1,836
Fondi total limit i prokuruar	3,479,402,472
Fondi total i ofruar pa tvsh	3,419,587,403
% që zë fondi total I ofruar ndaj fondit limit të prokuruar	98.3%
Fondi total I kursyer	59,815,069
% që zë fondi I kursyer ndaj fondit limit të prokuruar	1.7%

Nga analizimi i të dhënave si më sipër rezulton se vetëm 870 procedura me negociim pa shpallje paraprake janë zhvilluar në periudhën Prill–Dhjetor të vitit 2015.

Konkretisht numri i procedurave me negociim pa shpallje paraprake të realizuar sipas muajve paraqitet si më poshtë:

Njoftime kontratash të nënshkruara për procedurat me negociim pa shpallje paraprake			
	Nr i procedurave	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH
Janar	579	1,121,765,203	1,102,753,638
Shkurt	823	729,571,190.7	711,251,669.1
Mars	434	1,628,066,078	1,605,068,016
Prill	151	415,416,249.4	409,251,750.9

Maj	89	932,970,240	925,151,434.5
Qershor	148	745,883,915.3	729,796,081.9
Korrik	92	770,853,174.4	767,376,155.3
Gusht	52	291,812,283.6	282,078,678.3
Shtator	49	362,441,322.1	359,883,647
Tetor	67	254,427,069.5	253,795,842.1
Nëntor	77	608,662,169	602,513,809.5
Dhjetor	145	872,371,313.2	862,322,128.9
TOTALI	2706	8,734,240,209	8,611,242,851

Sugjerimi i vazhdueshëm i APP, me qëllim shmangien e krijimit të situatave të emergjencave në autoritetet kontraktore, ka qenë:

- Heqja e pengesës së krijuar nga Udhëzimi i Ministrisë së Financave, sipas të cilit nuk lejohet zhvillimi i një procedure prokurimi pa u konfirmuar nga Drejtoria e Thesarit, gjendja e llogarisë së Autoritetit Kontraktor;
- Respektimi me rigorozitet nga të gjitha palët e përfshira në proces (autoriteti kontraktor, Organi Qendror Blerës, Komisioni i Prokurimit Publik) i afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik;
- Përdorimi i Marrëveshjes Kuadër, sidomos në rastet e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme dhe sidomos nga organet që shërbejnë si organe qendrore blerëse, qoftë Organi Qendror Blerës pranë Ministrisë së Brendshme, qoftë organet që përqendrojnë nevojat e organeve të varësisë.

Nga gjithë sa analizuar më sipër, APP është e qëndrimit se nëse do të merren masat e sugjeruara në mënyrë të vazhdueshme, për të shmangur situatat kur autoritetet kontraktore janë të pambuluar me kontrata për nevojat e tyre, numri i procedurave me negociim pa shpallje paraprake do të minimizohej.

Në formë tabelore, të dhënat për prokurimin elektronik dhe procedurat negociim pa shpallje paraprake të njoftimit si dhe raportet në % dhe fondi i kursyer në total, për vitin 2015, janë si më poshtë:

Prokurime elektronike dhe Procedura me Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit për Periudhën Janar-Dhjetor 2015	
Nr.Total i Procedurave të publikuara elektronike	4,630
Fondi total limit i procedurave të publikuara elektronike	90,702,378,325
Nr.Total i Procedurave të fituara elektronike	4,269
Fondi total limit i procedurave të fituara elektronike	70,811,023,577
Fondi total i prokuruar i procedurave të fituara elektronike	64,324,508,777
Nr.Total i Proedurave të fituara Negocim pa shpallje	2,706
Fondi total limit i prokuruar negocim pa shpallje	8,734,240,209
Fondi total i ofruar negocim pa shpallje	8,611,242,851
% që zë nr i procedurave të fituara negocim pa shpallje ndaj nr total të procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	38.8%
% që zë fondi limit i procedurave me negocim pa shpallje ndaj fondit limit total (elektronik+negocim pa shpallje) për procedurat e fituara	11.0%
% që zë fondi i ofruar për procedurat me negocim pa shpallje ndaj fondit total (elektronik+negocim pa shpallje) për procedurat e fituara	11.8%
Nr.Total i Procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	6,975
Fondi total limit i prokuruar i procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	79,545,263,786
Fondi total i ofruar i procedurave të fituara (elektronik+negocim pa shpallje)	72,935,751,628
% që zë Fondi i ofruar ndaj Fondit limit të prokuruar	91.7%
Fondi total i kursyer	6,609,512,158
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit të prokuruar	8.3%

Megjithë analizën e mësipërme dhe numrin e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, vlen të theksohet fakti se, fondi limit i prokuruar me këtë lloj procedure **(8,734,240,209)** është shumë më i ulët, krahasuar me fondin total të prokuruar me procedurat e tjera konkurruese **(90,702,378,325)**.

7.2.3. Marrëveshjet Kuadër

Për herë të parë gjatë këtij viti, nga analizimi i të dhënave rezulton se autoritetet kontraktore kanë filluar të përdorin Marrëveshjen Kuadër. Këto të dhëna janë një tregues konkret i punës dhe iniciativave të APP për të stimuluar përdorimin e Marrëveshjes Kuadër, si një instrument i rëndësishëm për përmbushjen e nevojave të autoriteteve kontraktore nëpërmjet procedurave transparente dhe konkurruese.

Konkretisht të dhënat në lidhje me përdorimin e këtij instrumenti, paraqiten si më poshtë:

Njoftime Kontratash për procedurat Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2015

Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2015		
Lloji i procedurës	Nr	Fondi Limit
I Hapur Lokal	15	282,736,950
Kërkesë për Propozim	19	71,442,840.53
Totali	34	354,179,790.5

Njoftime Fituesi për procedurat Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2015

Njoftime Fituesi për procedurat Marrëveshje Kuadër Janar-Dhjetor 2015				
	Nr	Fondi Limit	Fondi i prokuruar	Diferenca e kursyer
I Hapur Lokal	8	114,551,427	111,484,709.3	3,066,717.7
Kërkesë për Propozim	16	60,097,247.53	56,642,847.53	3,454,400
Totali	24	174,648,674.5	168,127,556.8	6,521,117.7

Njoftime Kontratash të Nënshkruara (Minikontratat) për procedurat Marrëveshje Kuadër

Marrëveshje Kuadër Minikontrata Janar-Dhjetor 2015		
	Nr	Vlera e kontratës
Totali	139	141,692,602.2

7.2.4. Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël

Me ndryshimet nëligjore në fund të vitit 2014, u vendos që kufiri i prokurimeve me vlerë të vogël të rritej nga 400.000 mijë lekë në 800.000 mijë lekë. Ky ndryshim u bë me qëllim rritjen e operativitetit të autoriteteve kontraktore për vlera relativisht të vogla. Kjo rritje e kufirit u konsiderua në kushtet kur prej dy vitesh, edhe prokurimet me vlera të vogla bëheshin në formë elektronike, pra transparenca sigurohet maksimalisht edhe për këto lloj procedurash.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm i bërë në vitin 2015 në këtë drejtim, ishte dhe parashikimi në udhëzimin përkatës të APP, të rregullit që autoritetet kontraktore do të ftojnë për të marrë shërbimin/mallin/punën, vetëm pesë operatorët ekonomikë të renditur të parët.

Numri i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara gjatë vitit 2015 dhe fondet përkatëse, paraqiten si më poshtë:

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël Janar-Dhjetor 2015	
Nr Total i Blerje me Vlerë të Vogël	22 435
Fondi total limit i Blerje me Vlerë të Vogël	10,261,006,899
Fondi total i prokuruar i Blerje me Vlerë të Vogël	4,461,753,541
Nr.Total i Blerje me Vlerë të Vogël të cilat kanë vazhduar	19,828
Nr.Total i Proçedurave të papërfundura(anulluar,etj)	2,607
% që zë Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	43.50%
Fondi total i kursyer	5,799,253,358
% që zë Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	56.50%

Po të krahasojmë numrin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara në vitin 2015 (**19 828**), me numrin e tyre në vitin 2014 (**46 537**), rezulton se gjatë vitit 2015 në numër janë zhvilluar më pak se gjysma e atyre të zhvilluara në vitin 2014. Ndërkohë po të krahasojmë vlerat respektive, rezulton se fondi i prokuruar me këtë lloj procedure gjatë vitit 2015 (**10,261,006,899**), është më i madh se sa fondi i prokuruar në vitin 2014 (**9,175,402,305**).

Të dy këta tregues (numri i procedurave dhe vlerat përkatëse) janë rezultat i drejtpërdrejtë i rritjes së kufirit monetar për prokurimet e vogla. Nga ana tjetër, ulja e numrit të kësaj lloji procedure (ndërkohë që vlera është rritur) është dhe një lehtësi për sistemin e prokurimit elektronik, pasi ndikon drejtpërdrejt në ngarkesën teknike që krijohet në sistem.

Një tregues tjetër shumë i rëndësishëm që rezulton nga të dhënat në tabelë, është diferenca midis fondit me të cilin janë shpallur procedurat me fondin me të cilin janë fituar ato dhe konkretisht kursimi është **56.50%**, pra më shumë se gjysma e fondit të shpallur është kursyer. Ky kursim është shumë më i madh dhe po të krahasohet me vitin e kaluar, ku kursimi ka qenë vetëm **14.5%**. Në këtë përqindje kursimi, gjatë vitit 2015, ka ndikuar si rritja e kufirit monetar, ashtu edhe rregulli sipas të cilit autoritetet kontraktore mund të përzgjedhin fituesin vetëm ndër 5 operatorët ekonomikë të klasifikuar të parët (pra 5 ofertat më të ulëta).

Po kështu nga krahasimi i të dhënave të vitit 2015 dhe atyre respektive të vitit 2014, rezulton se numri i procedurave me vlerë të vogël, të anuluar në vitin 2015 (**2607**) është shumë më i vogël, krahasuar me ato të anuluar në vitin 2014 (**15 373**). Ky është një tregues i rritjes së përgjegjshmërisë dhe kapaciteteve administrative në autoritetet kontraktore.

7.2.5. Statistika në lidhje me numrin e procedurave të dhënies me koncesion/PPP gjatë vitit 2015

Numri i procedurave për dhënien me koncesion/PPP, të shpallura për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimit elektronik, njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të nënshkruara, të dërguara gjatë vitit 2015, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Procedura për dhënien me koncesion /PPP	Numri i procedurave
Njoftime Kontratash	15
Njoftime Fituesish	11
Njoftime Kontratash të Nënshkruara	4

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, duhet mbajtur në konsideratë fakti që njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të procedurave koncesionare/PPP, nuk i referohen vetëm procedurave të shpallura për t'u zhvilluar në 2015, por disa prej tyre janë njoftime që lidhen me procedura të shpallura që në vitin 2014.

Konkretisht, nga 11 njoftimet e fituesit të dërguar për publikim në vitin 2015, 6 njoftime janë për procedura të shpallura po në 2015, kurse 5 njoftime i referohen procedurave të shpallura në 2014. Po kështu, nga 4 njoftimet e kontratave të nënshkruara, 2 prej tyre i referohen procedurave që janë shpallur për zhvillim në vitin 2015, kurse 2 të tjerat i referohen procedurave të shpallura për zhvillim që në vitin 2014.

7.2.6. Statistika në lidhje me procedurat e ankandit publik të zhvilluara gjatë vitit 2015

Gjatë vitit 2015 janë shpallur në Buletinin e Njoftimeve Publike edhe procedura të ankandit publik, procedura këto të cilat zhvillohen vetëm në rrugë shkresore. Konkretisht, të dhënat në lidhje me këtë procedurë paraqiten si më poshtë:

Procedura të ankandit publik	Nr	Vlera e ofertuar
Njoftime Fituesish	220	1,313,358,092
Njoftime Kontratash të Nënshkruara	83	594,897,804
Njoftime Anullimi	179	

Në analizimin e të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, duhet mbajtur në konsideratë që këto njoftime janë dërguar për publikim në vitin 2015, por një pjesë e tyre lidhen me procedura të shpallura për t'u zhvilluar që në vitin 2014. Të shpërndarë sipas muajve, njoftimet e fituesit dhe njoftimet e kontratave të nënshkruara të procedurave të ankandit, paraqiten si më poshtë:

Njoftime Fituesish për Ankandet Janar- Dhjetor 2015

Muaji	Nr i Procedurave	Vlera e Ofertuar
Janar	11	16,750,934
Shkurt	9	4,016,203.85
Mars	23	39,500,081
Prill	13	1,313,358,092
Maj	27	712,497,660.3
Qeshor	31	133,439,999.8
Korrik	16	76,564,368.6
Gusht	18	64,994,541

Shtator	11	191,375,721.3
Tetor	17	12,583,159.3
Nentor	15	11,714,366
Dhjetor	29	39,778,010.9
Totali	220	2,616,573,138

Njoftime Kontratash të Nënshkruara për Ankandet Janar-Dhjetor 2015

Muaji	Nr i Procedurave	Vlera e Ofertuar
Janar	10	20,013,779
Shkurt	4	22,513,418
Mars	12	8,449,790
Prill	9	13,684,900.5
Maj	8	7,676,904.2
Qeshor	9	401,516,625
Korrik	12	65,734,326.92
Gusht	6	7,538,908
Shtator	3	35,645,936
Tetor	3	4,659,297
Nentor	3	1,004,420
Dhjetor	4	6,459,499
Totali	83	594,897,803.6

7.3. SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Sektori i Teknologjisë së Informacionit, edhe pse me numër të reduktuar të stafit të IT, gjatë vitit 2015 ka bërë përmirësime të ndjeshme në infrastrukturën e Sistemit të Prokurimit Elektronik, në bashkëpunim dhe me institucione si Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit, për shtimin e funksionaliteteve, automatizimin e sa më shumë proceseve, përmirësimin e infrastrukturës duke bërë të mundur procesimin e të dhënave katër herë më shpejt si dhe rritjen e sigurisë.

Ky bashkëpunim ka rezultuar i suksesshëm në ofrimin e shërbimeve me siguri të lartë për të gjithë Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë, Audituesit si dhe çdo Autoritet tjetër që, në përmbushje të detyrave të tij, përdor Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Detyrat kryesore që ka përmbushur ky sektor për vitin 2015 kanë qenë si më poshtë:

- Garantimi në kohë dhe me cilësi i ecurisë së punës për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE).
- Zgjidhja e problematikave të ndryshme hardware dhe software, gjatë punës së përditshme duke garantuar ecurinë normale të prokurimit elektronik.
- Rritja e kapaciteteve për Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemin e Arkivës Elektronike (SAE). Përmirësimi i vazhdueshëm dhe optimizimi i ndërfaqes, me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e punës së përdoruesve.
- Garantimi i sigurisë fizike të SPE dhe SAE në ambjentet e caktuara. Në këtë kuptim, të gjitha asetet e informacionit të APP duhet të mbrohen në shkallën më të lartë nga dëmtimet fizike. Rrjeti informatik u nënshtrohet rregullave për sigurimin fizik të informacionit, të përcaktuara në manualin e dorëzuar nga USAID “e-Procurement Security Policy and Procedures Manual”.
- Garantimi i Konfidencialitetit të ofertës ekonomike duke bërë enkriptimin dhe dekriptimin çka ka bërë që Informacioni me ndjeshmëri të lartë të jetë i përdorshëm vetëm për ata persona që janë të autorizuar ta shohin ose ta përdorin atë.
- Krijimi i një portali të ri i cili do të zëvendësojë portalin e vjetër duke përmbushur me saktësi të gjitha nevojat për informacionin e përdoruesve si dhe duke optimizuar ndërfaqet, duke shpejtuar me katër herë kohën e shfletimit në të. Publikimi i të gjithë informacionit në portalin e ri, si dhe krijimi i një paneli të sigurt për regjistrimin e operatorëve të huaj.
- Optimizimi i ndërfaqeve të publikimit në portal për Buletinin e Njoftimeve Publike, Njoftimin e Kontratës së Shpallur, Njoftimin e Fituesit, Njoftimin e Lidhjes së Kontratës, Procedurat e Arkivuara si dhe krijimi i një ndërfaqe të re ku shfaqen vetëm Prokurimet me Vlerë të Vogël e kanë bërë portalin më user-friendly.
- Pasurimi i portalit të APP, me informacion të përditësuar në lidhje me procesin e prokurimit, nëpërmjet publikimit të 52 buletinëve javorë, publikimit të legjislacionit të përditësuar, vendimeve, udhëzimeve, raporteve, moduleve të trajnimit, monitorimeve, regjistrave të parashikimeve, realizimeve etj, në total 76 dokumenta, publikimi i 32 njoftimeve të ndryshme të aspektit teknik, në lidhje me funksionimin e sistemit, publikimi i Dokumentave Standarte të Tenderit të reja, në total 22 dokumenta.

- Sigurimi i back-up ditor, javor dhe mujor i Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE), si dhe ruajtja tek AKSHI.
- Upgrade për Domain Controller, Web dhe databazën e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) (kalimi nga Windows 2003 në Windows 2012 dhe nga SQL 2003 në SQL 2008), testimi i tyre, evidentimi i problemeve, raportimi dhe ndjekja deri në zgjidhjen e tyre si dhe Sistemit të Arkivës Elektronike (SAE).
- Implementimi dhe lidhja e databazës së SPE-së me databazën e Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit dhe garantimi për bashkëpunim ndërmjet tyre.
- Garantimi i asistencës teknike për çdo kërkesë (kërkesat për dekriptim dokumentash, kërkesat për zëvendësim të anëtarëve të KVO, kërkesat për sqarim, ankesat nga ana teknike), të mbërritur në APP.
- Monitorimi i kontratës së mirëmbajtjes për Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dhe Sistemin e Arkivës Elektronike (SAE).
- Garantimi i asistencës teknike për telefonatat dhe e-maillet e mbërritura në APP.
- Hartimi i specifikime teknike për kontratat që APP do të lidhë me të tretët.
- Krijimi, azhurnimi si dhe mbyllja e llogarive të administratorit për Autoritetet Kontraktore. Për vitin 2015 janë shtuar 58 Autoritete Kontraktore të reja që përdorin Sistemin e Prokurimit Elektronik. Ky numër ka shkuar në 2245 Autoritete Kontraktore me llogari aktive.
- Krijimi, azhurnimi si dhe mbyllja e llogarive të përdoruesit për Autoritetet Kontraktore si dhe Audituesit.
- Krijimi, azhurnimi si dhe mbyllja e llogarive të përdoruesit për Operatorët Ekonomikë.
- Monitorimi i procedurave të prokurimit të lëna pezull në sistem dhe tërheqja e vëmendjes ndaj personave përgjegjës konform legjislacionit në fuqi.
- Implementimi i sistemit të back up në tape në mënyrë që të rritet siguria e ruatjes së të dhënave si dhe hartimi dhe zbatimi me përpikmëri i protokollit të ruatjes së tape-ve.
- Pasqyrimi i përjashtimeve të operatorëve ekonomikë në portalin e APP.

- Arkivimi i të gjitha procedurave të lëna pezull nga Autoritetet Kontraktore. Ky proces bën të mundur që sistemi operacional, në të cilin kryhen të gjitha procedurat e prokurimit publik, të lehtësohet ndjeshëm duke ulur gjithmonë e më shumë numrin e procedurave që ndodhen në të dhe, për pasojë, duke lehtësuar punën e përdoruesve të sistemit (Autoritete Kontraktore, Operatorë Ekonomikë, Auditues).
- Garantimi i asistencës teknike për llogari audituese për çdo auditues të Autoriteteve Kontraktore si dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Garantimi i detyrimeve në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare.
- Garantimi i trajnimeve për institucionet qendore dhe vendore në fushën e prokurimit publik në fushën e IT.

Sektori i Teknologjisë së Informacionit është përpjekur maksimalisht, edhe pse me një numër të reduktuar të specialistëve IT, për të mbajtur “online” Sistemin e Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës, përveç rasteve kur nxjerrja e tij “offline” për një periudhë shumë të kufizuar, të nevojshme për kryerjen e shërbimeve përkatëse, paralajmërohet me anë të një njoftimi pa cenuar në asnjë moment afatet e procedurave të prokurimit.


Qëndrimi në gatishmëri, jashtë orarit zyrtar të punës, gjatë fundjavës si dhe ditëve të cilat janë festa zyrtare i specialistëve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, duke monitoruar ecurinë e punës në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës kanë qenë në total rreth 2400 orë për vitin 2015.

Rezultati i punës së Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit ka qenë administrimi i sigurt i një totali baze të dhënash prej:

- i. 715 GB (767,777,769,984 bytes) të Sistemit të Prokurimit Elektronik, dhe
- ii. 7.92 TB (8,718,846,291,456 bytes) të Sistemit të Arkivës Elektronike.

Tabela e kapaciteteve të bazës së të dhënave sipas viteve:

	Viti 2013	Viti 2014	VITI 2015
Sistemi i Prokurimit Elektronik (në bytes)	602,749,889,024	602,749,889,024	767,777,769,984
Arkiva Elektronike (në bytes)	5,260,529,421,824	7,234,786,510,766	8,718,846,291,456
Totali (në bytes)	5,863,279,310,848	7,837,536,399,790	9,486,624,061,440
Totali (në Terabyte)	5.863279311	7.8375364	9.486624061

Grafiku i kapacitetit te bazes se te dhenave per Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Sistemin e Arkivës Elektronike ne TB

7.3.1. Dhënia e asistencës teknike brenda dhe jashtë APP

Mbështetja teknike që u jepet të gjitha autoriteteve kontraktore si dhe të gjithë operatorëve ekonomikë të huaj dhe vendas të cilët përdorin sistemin e prokurimit elektronik, nëpërmjet e-mail-ëve, telefonit apo dhe konsultimeve në ambientet e APP, është një punë e përditshme për këtë drejtori. Këtu vlen të përmendet se numri i telefonatave të marra nga drejtorja ka qenë rreth **60** telefonata në ditë.

Gjatë vitit 2015, nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit:

Janë përgatitur **2150** shkresa në total, ku përfshihen:

- Krijim/ Mbyllje llogarie në rolin CA Admin dhe Operator Ekonomik, si dhe rikthim fjalëkalimi në gjendje fillestare;
- Shkresa sqaruese me Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë;
- Shkresa për dërgim të dhënash dhe bashkëpunim me institucionet e tjera;
- Memo të brendshme dhe memo për bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe të Monitorimit në APP;

Janë dërguar **3500** e-maile në total, drejt:

- operatorëve ekonomikë (për konfirmimin e regjistrimeve të bëra online, për rikthim të fjalëkalimit në gjendjen fillestare, për sqarime, udhëzime dhe ankesa);
- autoriteteve kontraktore (për sqarime dhe udhëzime të karakterit teknik);
- institucioneve të tjera (për dërgim të dhënash dhe informacionesh);

Dhënia e asistencës teknike nga ky sektor është bërë edhe nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, të organizuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Shkolla e Administratës Publike, ku specialistë të IT, kanë mbuluar sesionet mbi përdorimin e Sistemit Elektronik të prokurimeve.

Gjatë vitit 2015, Sektori i Teknologjisë së Informacionit ka punuar intensivisht me Drejtorinë Juridike dhe të Monitorimit për përmirësimin e manualeve dhe udhëzimeve për përdoruesit e Sistemit të Prokurimit Elektronik, të cilat janë përshkruar më sipër, në këtë analizë. Këto udhëzime janë shumë të detajuara dhe me pamje nga sistemi, duke ndjekur teknikisht çdo fazë të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, parë nga të gjithë rolet e përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Bashkëpunimi i Drejtorisë së IT-së me Drejtorinë Juridike dhe të Monitorimit ka qenë shumë produktiv edhe për sa i përket evidentimit të rasteve problematike dhe zgjidhjen e tyre, si dhe në përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik, konform legjislacionit në fuqi.


7.3.2. Krijimi i përdoruesve të rinj për vitin 2015

Për vitin 2015 në sistemin e prokurimit elektronik janë krijuar **6201** përdorues të rinj, dhe përkatësisht:

Nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2015 janë krijuar **58** llogari të reja “Administrator” për Autoritetet Kontraktore në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Numri total i Autoriteteve Kontraktore që përdorin Sistemin e Prokurimit Elektronik shkon në **2245**. Gjatë vitit 2015, nga këto Autoritete Kontraktore janë krijuar përdorues si në tabelën më poshtë:

Përdoruesit e Autoriteteve Kontraktore të regjistruar për vitin 2015													
	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje	Totali
N r	596	815	843	664	450	359	339	348	491	452	515	329	5 386


Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i përdoruesve të Sistemit të Prokurimit Elektronik, brenda Autoriteteve Kontraktore, të krijuar përkatësisht në vitin 2015. Nga figura shihet qartë numri më i madh i përdoruesve është krijuar në muajt Shkurt dhe Mars, e cila është dhe perioda kur është e përqendruar shpallja e procedurave të reja.



Për vitin 2015, në sistemin e prokurimit elektronik në rolin e operatorëve ekonomikë janë regjistruar **1753** operatorë ekonomikë të rinj, nga të cilët **173** janë operatorë ekonomikë të huaj.

Operatorët Ekonomikë të Regjistruar në vitin 2015	
Operatorët Lokalë	1580
Operatorët Ekonomikë të Huaj	173
Totali	1753

Në diagramën e mëposhtme paraqitet numri i Operatorëve Ekonomikë të rinj të Sistemit të Prokurimit Elektronik, të krijuar përkatësisht në vitet 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Këtu vihet re qartë numri në rritje i përdoruesve të krijuar në vitin 2015, krahasuar me vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Kjo rritje shpjegohet me interesimin gjithmonë e më të madh të Operatorëve Ekonomikë për të marrë pjesë në prokurimet publike.




Një nga detyrat e përditshme të Sektorit të IT-së konsiston edhe në suportin e përdoruesve brenda APP si dhe në menaxhimin e infrastrukturës së rrjetit të brendshëm kompjuterik dhe telefonik.

7.3.3. Statistika në lidhje me procedurat e krijuara në sistemin elektronik

Numri total i aplikimeve të krijuara nga Njësitë e Prokurimit pranë Autoriteteve Kontraktore për vitin 2015 në Sistemin e Prokurimit Elektronik është **49668**. Nga këto:

- **43613** janë aplikime për prokurime me Vlerë të Vogël;
- **6055** janë aplikime për Procedura Konsulente, Konkurs Projektimi, Procedura me Negociim me Shpallje Paraprake të Njoftimit, Procedura të Hapura, Kërkesë për Propozim, etj.

Në diagramën e mëposhtme tregohet raporti i numrit të prokurimeve me vlerë të vogël, ndaj procedurave mbi vlerën 800.000 lekë, ku, sikurse dhe nga treguesit e analizuar më sipër, del qartë volumi më i madh që zënë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël ndaj procedurave të tjera.



Megjithatë, pavarësisht se në raportin në numër dominojnë procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, duhet theksuar se në raportin në vlerë, dukshëm dominojnë procedurat e prokurimit mbi vlerën 800.000, duke qenë se raporti është në të kundërt; fondi i prokuruar me procedurë

prokurimi me vlerë të vogël zë rreth 11%, kurse fondi i prokuruar me procedura të tjera zë rreth 89%.

7.3.4. Statistika në lidhje me ofertat e krijuara në sistemin elektronik për procedurat e arkivuara


Gjatë vitit 2015, për procedurat e finalizuar deri në datën 31/12/2015, në SPE janë krijuar këto oferta nga operatorët ekonomikë:

Informacion mbi Ofertat Elektronike per vitin 2015	
Nr i Procedurave/ Loteve	3605
Nr Total i Ofertave për Procedurat e Prokurimit	14402
Mesatarja e Ofertave për Procedurat e Prokurimit	3.995006935
Nr i Prokurimeve me Vlerë të Vogël	26038
Nr total i Ofertave për Prokurimet me Vlerë të Vogël	367902
Mesatarja e Ofertave për Prokurimet me Vlerë të Vogël	14.12942622

Sikurse rezulton nga të dhënat në tabelën e mësipërme, mesatarja e ofertave në prokurimet me vlerë mbi 800.000 lekë është rreth 4 oferta për procedurë, kurse në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël kjo mesatare shkon rreth 14 oferta për procedurë. Kjo e dhënë është një tregues i përdorimit të mundësisë për të ofertuar në procedura prokurimi, sidomos nga bizneset e vogla dhe të mesme, që janë dhe ofertuesit kryesorë në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.


7.3.5. Statistika të tjera në lidhje me përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik

Në Sistemin e Prokurimit Elektronik, për vitin 2015 në total kemi **7530170** klikime:



N	Item	Hits	%
1	/ep/login.aspx&ReturnUrl=/ep/MY_Workplace.aspx	2884838	38.31
2	/ep/ASP.Net/Resources/FM/DataViewer/FramePage.aspx&lang=1052	2063594	27.40
3	/ep/default.aspx&UR=http://www.app.gov.al/	355325	4.72
4	/ep/login.aspx&ReturnUrl=/ep/default.aspx	331972	4.41
5	/ep/default.aspx&UR=http://app.gov.al/	309395	4.11
6	/ep/default.aspx&UR=https://www.google.al/	192797	2.56
7	/login.aspx&ReturnUrl=/ep/default.aspx	147643	1.96
8	/ep/login.aspx&ReturnUrl=/ep/Messages.aspx	126558	1.68
9	/ep/login.aspx&ReturnUrl=/ep/default.aspx?UR=http://app.gov.al/	111431	1.48
10	/ep/login.aspx&ReturnUrl=/ep/default.aspx?UR=http://www.app.gov.al/	110829	1.47
11	/ep/login.aspx&ReturnUrl=/ep/default.aspx?UR=https://www.google.al/	50215	0.67
12	/ep/default.aspx&UR=https://www.google.com/	33138	0.44
13	/ep/login.aspx&ReturnUrl=/ep/ContractNotice.aspx	29912	0.40
14	/ep/ASP.Net/Resources/FM/DataViewer/ControlLoader.aspx&_src=ASP.Net/Components/UserList/AddNew.aspx&popup=yes&roles=yes&rado=yes&profile=ca	22433	0.30
15	/ep/DF_DocumentViewer.aspx?id=3a7cee03-13b1-49ab-b40e-80bba05f3bea	19965	0.27
16	/ep/DF_DocumentViewer.aspx?id=625b4824-5691-4975-b510-7953744531ff	16548	0.22
17	/ep/DF_DocumentViewer.aspx?id=fe9e0b5d-91b4-48cc-aa5f-e17729ec06db	15180	0.20
18	/ep/ASP.Net/Resources/FM/DataViewer/FramePage.aspx&lang=1033	14971	0.20
19	/login.aspx&ReturnUrl=/ep/MY_Workplace.aspx	14869	0.20
20	/ep/default.aspx&UR=https://www.google.al/url?sa=t	12074	0.16
Other		666483	8.85
Total		7530170	100%


Grafiku i mëposhtëm pasqyron shpërndarjen e klikimeve, vizitorëve dhe kohës së shpenzuar sipas muajve:




Date	Hits	Unique Visitors	Bandwidth, Mb	Visit Depth, avg	Visit Time, avg
1/1/2015	4099609	36366	0	112.73	00:07:38
2/1/2015	6889865	40985	0	168.11	00:08:09
3/4/2015	5752387	29463	0	195.24	00:08:05
4/4/2015	9781007	54224	0	180.38	00:07:39
5/5/2015	11577359	59467	0	194.69	00:08:21
6/5/2015	8413605	51495	0	163.39	00:07:57
7/6/2015	8131577	57803	0	140.68	00:07:30
8/6/2015	8679043	69423	0	125.02	00:07:19
9/6/2015	11445737	82258	0	139.14	00:07:38
10/7/2015	10034433	64954	0	154.49	00:07:37
11/7/2015	9141376	53571	0	170.64	00:07:44
12/31/2015	6593962	38590	0	170.87	00:07:55

Më poshtë jepet aktiviteti i përdoruesve sipas vizitorëve/IP.:

Visitor / IP




Gjithashtu, nga analizimi i të dhënave del grafiku i mëposhtëm, që tregon aktivitetin e përdoruesve sipas shteteve:



N	Item	Uniques	%
1	ALBANIA	233315	36.53
2	Kosovo	148515	23.25
3	GREECE	113184	17.72
4	THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA	28516	4.46
5	ITALY	23718	3.71
6	UNITED STATES	17233	2.70
7	CHINA	15229	2.38
8	RUSSIAN FEDERATION	9835	1.54
9	GERMANY	7139	1.12
10	UNITED KINGDOM	6067	0.95
11	Turkey	5580	0.87
12	NORWAY	5525	0.86
13	FRANCE	4846	0.76
14	SERBIA	3575	0.56
15		2659	0.42
16		1560	0.24
17		1386	0.22
18		977	0.15
19		865	0.14
20		614	0.10
	Other	8399	1.31

Grafiku i mëposhtëm pasqyron aktivitetin e vizitorëve:

N	Parameter	Count
1	Unique Visitors : total (average)	638599 (53216)
2	Visits From Referring Sites	377846
3	Visits from Search Engines	35742
4	Hits: total (average)	100539960 (8378330)
5	Bandwidth: total (average), Mb	0 (0)
6	Visit Depth, average	159.61
7	Visit Time, average	00:07:47




8. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE, INTEGRIMIT DHE FINANCËS

8.1. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Në vijim të ndryshimeve më të fundit të bëra në Ligjin për Prokurimin Publik, objektivat institucionale dhe shtimin e kompetencave të monitorimit të institucionit, u bë i domosdoshëm ndryshimi i strukturës dhe organikës së APP, ndryshim i cili u miratua me Urdhërin Nr. 13, datë 11.02.2015 të Kryeministrit, në bazë të propozimit të paraqitur nga APP.

Sipas këtij Urdhri, APP ushtron aktivitetin e saj ligjor me 2 (dy) drejtori dhe 1 (një) sektor në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm, përkatësisht: (i) Drejtorinë Juridike dhe Monitorimit me 2 (dy) sektorë (Sektori i Monitorimit dhe Sektori Juridik); (ii) Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit me 2 (dy) sektorë (Sektori i Publikimit dhe Sektori i Teknologjisë së Informacionit) si dhe (iii) Sektorin e Integritit, Burimeve Njerëzore dhe Financës. Diagrama e strukturës së APP, paraqitet si më poshtë:



Me miratimin e strukturës së re, bazuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore të legjislacionit të shërbimit civil, u krye risistemimi i punonjësve brenda strukturës, duke pasur parasysh përshkrimet e punës së punonjësve ekzistues dhe përshkrimet e punës të miratuara me strukturën e re në fuqi.

Në fund të procesit të risistemimit, për shkak të ndryshimit të kriterëve në pozicionet e reja të krijuara dhe konkretisht fushës së arsimit të kërkuar, u propozua transferimi i përhershëm për një punonjës, profili 'inxhinieri ndërtimi' në një institucion tjetër të shërbimit civil, përshkrimi i punës së të cilit përshtatej me kriteret e përgjithshme edhe të veçanta që zotëronte nëpunësi në fjalë.

Gjithashtu, me qëllim plotësimin e strukturës, APP hartoi kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për çdo pozicion pune vakant të krijuar në institucion dhe i depozitoi ato me qëllim fillimin e rekrutimeve pranë Departamentit të Administratës Publike, si institucioni përgjegjës për zhvillimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil.

Kështu u bënë pjesë e administratës së institucionit gjithsej 5 (pesë) nëpunës, përkatësisht 3(tre) profili juridik dhe 2 (dy) profili ekonomik.

8.2. AUTORITETI PËRGJEGJËS

Autoriteti Përgjegjës në institucion ka mbajtur në mënyrë të rregullt kontaktet me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe ka raportuar emrat e personave përgjegjës për deklarimin e pasurive në institucion, si dhe ka dërguar në kohë deklaratimet përkatëse.

Gjatë këtij viti, në përputhje me detyrimin ligjor "për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik", APP ka depozituar në kohë Deklarimin e Interesave Privatë Periodik/Vjetor, për zyrtarët përkatës, si dhe ka regjistruar vetëm një rast të deklarimit të konfliktit të interesit, i cili është pasqyruar në regjistrin përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

8.3. AKTIVITETET NË DREJTIM TË FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË STAFIT TË APP DHE SPECIALISTËVE TË PROKURIMIT PUBLIK PRANË AUTORITETEVE KONTRAKTORE

8.3.1. Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve administrative, gjatë vitit 2015 përfaqësues të APP kanë marrë pjesë në një sërë takimesh dhe seminaresh të organizuar brenda dhe jashtë vendit, dhe konkretisht si më poshtë:

Në datë 19 Maj 2015, APP u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në konferencën e 3-të Europiane për prokurimin publik që u mbajt në Porto-Portugali.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, me ftesë të Ministrisë së Integritimit Evropian, APP mori pjesë në takimin e gjashtë të Komitetit të Stabilizim- Asociimit, me fokus “Marrëveshjen e Stabilizim- Asociimit, Dokumentin e Partneritetit Evropian 2007 për sa kohë i aplikueshëm, si dhe rekomandimet e nënkomiteteve të Stabilizim- Asociimit, përfshirë takimin e Grupit të Posaçëm mbi reformën në Administratën Publike, të zhvilluar gjatë vitit 2014 dhe 2015”.

Me ftesë të Ministrisë së Financave, APP është përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm në vizitën studimore të organizuar nga projekti i binjakëzimit Austriako-Francez në Paris, Francë, në datë 01- 06 Qershor 2015, me fokus implementimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar, kontrollit dhe inspektimit financiar publik në Shqipëri, financuar nga fondet IPA 2012.

Gjithashtu, APP mori pjesë me 2 (dy) përfaqësues të saj në forumin e 11-të të shkëmbimit të njohurive në prokurimin publik, të organizuar nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë në Batumi, Gjeorgji, në datat 9-12 Qershor 2015, me objekt “Mbikqyrja e prokurimit dhe monitorimi si mjet për implementimin efektiv të projektit”.

Në muajin Shtator, një përfaqësues i APP, së bashku me një përfaqësues nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Turizmit, mori pjesë në Workshopin dhe Simpoziumin mbi Government Procurement Agreement (GPA) – Marrëveshjen e Prokurimeve, të organizuara nga Organizata Botërore e Tregtisë, në Gjenevë, Zvicër, në datat 15-18 Shtator 2015.

Në muajin Nëntor, APP u përfaqësua me dy përfaqësues në Workshopin e përbashkët të organizuar nga RESPA dhe EBRD me temë diskutimi prokurimet publike dhe partneritetin publik privat. Ky aktivitet u zhvillua në Londër, në datat 16-17 Nëntor 2015.

8.3.2. Trajnimet e stafit të APP

Stafi i Agjencisë së Prokurimit Publik ka qenë pjesë e trajnimeve të vazhdueshme të organizuara nga Shkolla e Administratës Publike, me tematika të ndryshme në fushën e administratës publike.

Nëpunësit e rinj që i janë bashkuar administratës së institucionit me miratimin e strukturës së re, i janë nënshtruar trajnimit 9 (nëntë) ditor mbi prokurimin publik, me qëllim njohjen e detajuar të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik.

8.3.3. Trajnimet e punonjësve të prokurimeve pranë Autoriteteve Kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik, me qëllim njohjen e punonjësve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në Autoritetet Kontraktore të pushtetit qendror dhe vendor, ka organizuar trajnime në fushën e prokurimit publik.

Bazuar në nevojat specifike të Autoriteteve Kontraktore, APP në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike, apo organizma të tjerë përgjatë gjithë vitit ka organizuar sesione trajnimi 1(një) ditore, 2 (dy) ditore edhe 9 (nëntë) ditore, në fushën e prokurimit.

Një fokus të veçantë kanë pasur edhe trajnimet mbi Marrëveshjen Kuadër, ku APP në bashkëpunim me OECD/SIGMA ka organizuar në datat 24 dhe 25 Mars 2015 trajnimin mbi Marrëveshjen Kuadër, me pjesëmarrjen e nivelit të lartë drejtues edhe nivelit ekzekutiv, nga institucione kryesisht të nivelit qendror.

Gjatë muajit Prill, një vend të veçantë zënë trajnimet mbi ndryshimet e legjislacionet të prokurimit publik, ku janë organizuar 8 (tetë) seanca trajnimi 1- ditore, bazuar në kërkesat për trajnim të depozituara në institucion. Niveli i pjesëmarrjes ishte kryesisht nivel ekzekutiv dhe numri total i të trajnuarve shkoi në 161 nëpunës.

Për t'u ardhur në ndihmë specialistëve të sapo emëruar në prokurimin publik, APP ka organizuar trajnime me tematikë "Bazat e Prokurimit Publik", ku në muajin Qershor 2015 në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike zhvilloi 4 (katër) seanca trajnimi 2 (dy) ditore dhe numri total i të trajnuarve shkoi në 97 punonjës.

APP, në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike, organizoi një kurrikul trajnimi 9 ditore, për specialistët kryesisht njohës të fushës së prokurimit, në fund të të cilave çdo pjesëmarrës, në vijim të një testimi, u pajis me një çertifikatë mbi njohuritë në fushën e prokurimit publik. Kështu për periudhën Shtator- Dhjetor 2015, u organizuan 3 module 9 ditore dhe numri total i të trajnuarve arriti në 83 nëpunës.

Tabela e mëposhtme tregon numrin e të trajnuarve në total për vitin 2015, sipas temës së trajnimit:

Nr.	Tema	Kohëzgjatja	Numri i trajnimeve	Numri i të Trajnuarve
1	Marrëveshja Kuadër	1 (një) ditore	2 (dy)	40
2	Bazat e Prokurimit	2 (dy) ditore	4 (katër)	97
3	Ndryshimet e legjislacionit të prokurimit	1 (një) ditore	8 (tetë)	161
4	Prokurimi Publik	9 (nëntë) ditore	3 (tre)	83
TOTALI				381 nëpunës

8.4. INTEGRIMI

APP ka vijuar raportimin periodik pranë Ministrisë së Integrimit Evropian dhe Strukturave të përbashkëta BE-Shqipëri, në kuadër të procesit të Integrimit Evropian dhe detyrimeve që ky proces shoqëron përsa i përket fushës së prokurimit publik.

Në datë 5 Mars 2015 u zhvillua në Bruksel takimi i gjashtë i Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe të shëndetit”, gjatë të cilit APP raportoi me shkrim në mënyrë të detajuar mbi progresin e arritur, në drejtim të përafrimit të legjislacionit në këtë fushë, në bazë të pyetjeve specifike të dërguara nga Komisioni Evropian.

Në datë 23 Mars 2015 u zhvillua në Bruksel takimi i radhës i Komitetit të Stabilizim Asociimit, ku APP raportoi mbi progresin e arritur, në këtë fushë, për periudhën e kërkuar, kryesisht në drejtim të përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit dhe zbatimit të tij, si dhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve të institucioneve të përfshirë në rregullimin dhe zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik.

Gjithashtu, në kuadër të raportimit, është përgatitur në nivel kapitulli kontributi për raportin e progresit 2015 të Komisionit Evropian, për Shqipërinë, në fushën e prokurimit publik, ku për kapitullin 5 “Prokurimi publik”, APP është institucioni koordinues.

Në kuadër të ndryshimeve të prioriteteve të parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), 2014-2020 dhe rishikimin e tij nga Ministria e Integritimit, APP ka përgatitur edhe pjesën përkatëse për kapitullin 5 “Prokurimi publik”, duke përcaktuar prioritetet dhe masat legislative afatshkurtra (2016) dhe afatmesme (2017-2018) për përafrimin e legjislacionit në këtë fushë.

Gjithashtu, në vijim të miratimit të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike pjesë e të cilës është edhe Prokurimi Publik, APP ka punuar për detajimin e mëtejshëm të masave të parashikuara me qëllim implementimin e strategjisë.

Edhe gjatë këtij viti, si anëtare e grupit të punës së udhëhequr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për vetëvlerësimin e politikave të Aktit të Biznesit të Vogël, APP ka raportuar dhe ka dhënë komentet përkatëse në lidhje me masat dhe politikat e parashikuara në fushën e prokurimit publik, në kuadër të këtij Akti.

Gjithashtu, APP ka dhënë kontributin e saj edhe në kuadër të procesit të Rishikimit të Politikës Tregtare (TPR) për Shqipërinë në Organizatën Botërore të Tregtisë që pritet të zhvillohet në tremujorin e parë të vitit 2016. Në këtë kuadër, APP ka raportuar në lidhje me të gjitha ndryshimet e ndodhura në legjislacionin e prokurimit publik që nga viti 2010 kur është zhvilluar i njëjti proces për Shqipërinë.

8.5. GJENDJA FINANCIARE E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2015

Agjencia Prokurimit Publik në zbatim të ligjit Nr.160/2014, datë 27.11.2014 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2015”, për vitin 2015 ka marrë fonde nga buxheti i shtetit, si më poshtë:

Në 000/lekë

	Emërtimi	Plan vjetor 2015	Akt normativ 2015	Fakt 2015	Në %	Në vlerë
1	Shpenzime paga	21 494	19 894	19 831	99.7	63
2	Sigurime Shoqërore	3 836	3 176	3 167	99.7	9
3	Mallra Shërbime	19 00	19 000	18 912	99.5	88
4	Shpenzime për investime	6 000	6 000	4 114	68.6	1 886
	Totali i shpenzimeve	50 330	48 070	46 024	95.7	2 046

Konkluzioni kryesor që nxirret nga analizimi i tabelës së mësipërme, është se shpenzimet e përgjithshme të APP, në fund të vitit 2015, janë realizuar në masën 92.7 përqind, ose rreth 2 046 000 lekë më pak se plani i ndryshuar me Aktin Normativ Nr. 3, datë 28.12.2015.

Konkretisht, përqindja e shpenzimeve sipas zërave paraqitet si më poshtë:

	Struktura në %	Buxheti 2015
1	Paga	41.3
2	Sigurime Shoqërore	6.6
3	Mallra Shërbime	39.5
4	Shpenzime kapitale	12.5
	Totali i shpenzimeve	48 070

Shpenzimet me fondet e buxhetit u realizuan në zërin shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore përkatësisht 99.7 %, ndërkohë që shpenzimet operative u realizuan 99.5 %, dhe në investime 68.6 %.

Nga mosrealizimi i fondit të akorduar në fillim viti, për paga dhe sigurime shoqërore, për arsye të mosplotësismit të numrit të punonjësve, nga 28 të miratuar, në 23 punonjës në fakt, u bë pakësimi i fondeve për paga me 1.600 000 lekë dhe sigurime shoqërore me 660 000 lekë, të miratuara me Aktin Normativ Nr. 3, datë 28.12.2015, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”.

Peshën kryesore në shpenzimet operative e zë zëri shpenzime për mirëmbajtjen e sistemit, në nivelin 68.7% të totalit të shpenzimeve të planifikuara, ose 69 % të shpenzimeve të realizuara.

Në shpenzimet e këtij viti është shlyer pjesërisht detyrimi ndaj Zyrës së Përmbartimit Privat “Bailiff Services Matani &Co” Shpk, në favor të kreditorit, shoqëria “Avduli” Shpk, në shumën prej 2 100 000 lekë, kundrejt detyrimit total prej 9 255 955 lekë, me vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë. Diferenca e mbetur prej 7 155 955 lekë, mbetet për tu shlyer në periudhën në vazhdim.

Investimet nga 6 000 000 lekë fonde të akorduara në fillim të vitit, u realizuan në masën 68.6%, ose në vlerën 4 113 500 lekë, të cilat u shpenzuan për blerje pajisje elektronike sipas

parashikimit. Theksojmë se nga procedura e prokurimit publik rezultoi kursimi i fondit në masën 31.4 %.

Krahas fondeve nga buxheti i shtetit, Agjencisë së Prokurimit Publik, me vendimin e Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, Nr.36, datë 28.07.2015, “Për shpërndarjen e fondit për programin “Shqipëria Dixhitale”, shtylla e dytë, iu akordua çelja e fondeve për projektet e miratuara për programin “Shqipëria Dixhitale”, në vlerën 83 064 100 lekë për vitin 2015, dhe po në njëjtën vlerë edhe për vitin 2016. Realizimi i këtij projekti do të vijojë në vitin 2016.

Përsa i përket kontabilitetit dhe mbajtjes së llogarive sintetike dhe analitike, veprimet kontabël janë kryer konform dispozitave ligjore në fuqi, edhe detyrimet debitore dhe kreditore janë ndjekur sistematikisht.

APP nuk ka fatura të papaguara për shërbime të kryera gjatë vitit 2015.

9. PRIORITETET E AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2016

Megjithë progresin dhe arritjet e bëra gjatë vitit 2015, për realizimin e detyrave dhe përmbushjen e mëtejshme të angazhimeve të ndërmarra në fushën e prokurimit publik, për vitin 2016 APP ka një sërë prioritetesh, për të cilat duhet të punojë. Ndër to si më kryesoret, theksojmë:

1. Plotësimin e stafit të Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim organizimin e punës për të rritur në maksimum performancën në realizimin e detyrave ligjore;
2. Stimulimin e përdorimit të Marrëveshjes Kuadër, sidomos nga Organi Qendror Blerës si një mjet që siguron konkurrencën dhe transparencën në kryerjen e procedurave të prokurimit, edhe në rastet e situatave të paparashikuara. Përdorimi i këtij mjeti, do të ndikonte drejtëpërsëdrejti edhe në uljen e rasteve të përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit;
3. Minimizimin e rasteve të përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit;
4. Përafrimin e mëtejshëm të Ligjit të Prokurimit Publik me Direktivat e Bashkimit Europian në këtë fushë.
5. Rritjen e numrit të monitorimeve të procedurave të prokurimit, me qëllim monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit të prokurimit dhe udhëzimin e autoriteteve kontraktore për përmirësimin e veprimtarisë së tyre në këtë drejtim, në të ardhmen;
6. Trajnimin e zyrtarëve të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit, pranë autoriteteve kontraktore, me qëllim ngritjen e kapaciteteve administrative, për rritjen e performancës së AK në këtë drejtim;
7. Minimizimin e afateve dhe respektimin e tyre nga AK dhe Komisioni i Prokurimit për procedurat e prokurimit, me qëllim finalizimin në kohë dhe dhënien e një perceptimi të ri për ecurinë e procedurave tek Operatorët Ekonomikë duke shmangur gjithashtu zëvendësimin e anëtarëve të njësisë të prokurimit, komisioneve të hapjes dhe vlerësimit të ofertave në rastet e tejkalimit të afateve;
8. Dhënien e një perceptimi të ri për Sistemin e Prokurimit Elektronik duke përmirësuar ndjeshëm performancën, duke ofruar shërbime të reja nëpërmjet portalit dhe platformave mobile si edhe duke ngritur në një shkallë më të lartë monitorimin, raportimin dhe sigurinë e tij;

9. Zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të Sistemit të Prokurimit Elektronik nëpërmjet “Shërbimit të Automatizimit të Ekstrakteve historikë të thjeshtë” nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, me qëllim minimizimin e dokumentave të ngarkuara në këtë sistem nga Operatorët Ekonomikë duke minimizuar burokracitë;
10. Ri-inxhinierimin e strukturës së të dhënave dhe ngritjen e platformës aktuale të sistemit (framework) në versionet më të reja me qëllim rritjen e performancës së Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe shmangien sa më shumë të incidenteve që vijnë për shkak të saj;
11. Automatizimin e Regjistrave të parashikimeve dhe realizimeve;
12. Shtimin e shërbimeve elektronike në e-Albania për rritjen e transparencës dhe notifikimin e përdoruesve (publikë/operatorë ekonomikë) për llojet e tenderave që publikohen;
13. Mundësimin e ofertimit nëpërmjet aplikacioneve mobile për platformat kryesore iOS dhe Android për procedurat me blerje të vogël;
14. Shtimin e funksionaliteteve që mungojnë dhe pengojnë ecurinë normale të punës dhe që aktualisht zgjidhen duke raportuar incidente;
15. Krijimin e një sistemi dhe infrastrukture arkivimi për procedurat e përfunduara;
16. Krijimin e një sistemi “Business Intelligence” për raportime dhe analiza komplekse;
17. Krijimin e një infrastrukture testimi, e cila aktualisht mungon, për të krijuar kushtet për punë metodike gjatë ndërhyrjeve apo zhvillimeve;
18. Krijimin e një infrastrukture për “Business Continuity” në mjediset e APP, ndërkohë që Production duhet të vendoset në mjediset e AKSHI-t;
19. Mundësimin e monitorimit të sistemit me Audit Vault.